

FËMIJËT
INVESTIMI I SË ARDHMES

FËMIJËT INVESTIMI I SË ARDHMES

Studim

*Hartoi Marsela Tarelli
Redaktoi Petrit Bezhani*



ALSAR
Tiranë, 2013

FËMIJËT
INVESTIMI I SË ARDHMES

Studim

Hartoi
Marsela Tarelli

Redaktoi
Petrît Bezhani

Faqosja dhe kopertina
Ludi Cami Serica

Botues
ALSAR - Shoqata “Alternativa e së Ardhmes”
Tiranë, 2013

© Të gjitha të drejtat e ribotimit janë të rezervuara.
Asnjë riprodhim i pjesshëm ose i plotë nuk mund të
bëhet pa lejen e botuesit.

Përmbajtja

1. Rëndësia e zhvillimit të hershëm të fëmijës	8
2. Nevojat psikologjike të fëmijëve 0-6 vjeç	9
<i>Dashuria</i>	9
<i>Atashimi</i>	10
<i>Besimi</i>	11
<i>Pavarësia</i>	11
<i>Siguria</i>	12
<i>Vëmendja</i>	12
<i>Pranimi</i>	13
<i>Respekti</i>	13
<i>Të ndjerit i aftë</i>	13
<i>Përkatësia</i>	14
3. Marrëdhënia nënë - fëmijë	14
<i>Rëndësia e marrëdhënies nënë - fëmijë</i>	17
<i>Ç'janë çrregullimet e atashimit?</i>	19
4. Zhvillimi i trurit tek fëmijët 0-2 vjeç	20
<i>Eksperienca ndërton arkitekturën e trurit</i>	20
<i>Marrëdhënia nënë -fëmijë i jep formë qarqeve të trurit të fëmijës</i>	22
<i>Atashimi dhe hemisfera e djathtë e trurit -</i>	24
<i>- Dr. Allan Schore Phd</i>	
<i>Marrëdhënia e atashimit me nënën rregullon direkt</i>	26
<i>gjenomin e fëmijës - Dr. Allan Schore Phd</i>	29
<i>Gjidhënia dhe zhvillimi i trurit tek fëmija 0-2 vjeç</i>	30
<i>Sinkronizimi fytyrë më fytyrë</i>	
5. Formimi i personalitetit të fëmijës	32
<i>- Prof. Dr. Muhamed El -Mehdi</i>	
<i>Disa përfundime nga shkenca e psikologjisë së zhvillimit të fëmijës 0-6 vjeç</i>	32
6. Pasojat e kujdesit ditor nëpër çerdhe e kopshte mbi zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës	33
<i>Historik i shkurtër rreth qendrave të kujdesit ditor</i>	
<i>Ndikimi i kujdesit ditor të hershëm mbi atashimin me nënën</i>	37

<i>Kujdesi Ditor lidhet me sjellje agresive, kokëfortësi dhe kundërshtim</i>	38
<i>Zhvillimi njohës</i>	40
<i>Zhvillimi social</i>	42
<i>Stresi toksik shkatërron zhvillimin e shëndetshëm të fëmijës</i>	43
<i>Rreziqet shëndetësore</i>	44
<i>Pasojat afatgjata të kujdesit ditor</i>	45
<i>Mite dhe fakte rreth kujdesit ditor</i>	46
<i>Citate nga psikologë të njohur amerikanë</i>	47
<i>7. Çfarë duhet të mësojnë fëmijët e moshës parashkollore?</i>	48
<i>Nevojat zhvillimore të fëmijës</i>	49
<i>Pavarësia</i>	51
<i>Zhvillimi i shprehive të mira sociale dhe aftësive të komunikimit</i>	52
<i>Vetëvlerësimi</i>	54
<i>Zhvillimi i vëmendjes</i>	55
<i>Mësimi i bindjes ndaj prindërve</i>	56
<i>Mësimi i vetëkontrollit</i>	57
<i>Formimi i karakterit të fëmijës dhe cilët janë faktorët që e ndikojnë atë?</i>	58
<i>Çfarë lloj karakteri zhvillojnë fëmijët në çerdhe e kopshte dhe çfarë përbën ai për shoqërinë tonë?</i>	59
<i>Zhvillimi i aftësive krijuese dhe të menduarit kritik</i>	63
<i>Si mund t'i përgatitim fëmijët parashkollorë për në shkollë?</i>	65
<i>Menaxhimi i stresit dhe emocioneve</i>	67
<i>8. Këndëvshtrimi Islam mbi edukimin parashkollor</i>	68
<i>Edukimi fetar</i>	68
<i>Nga Dashuria tek Virtyti</i>	
<i>– Necla Koytak (psikologe turke)</i>	69
<i>Roli i gruas në familje, në shoqëri dhe punësimi i saj sipas fesë Islame</i>	73
<i>Familja shqiptare</i>	76
<i>Disa nga Shenjat e Kijametit në lidhje me prindërit dhe fëmijët</i>	79
<i>Feminizmi</i>	80
<i>Literatura e shfrytëzuar</i>	82

RËNDËSIA E ZHVILLIMIT TË HERSHËM TË FËMIJËS

Fëmijëria është periudha kur njeriu formohet si qenie më vete në kontakt të pandërprerë me ambientin që e rrethon. Nëse do ta krahasonim fëmijërinë me strukturën e një ndërtese, pa dyshim që ajo do të ishte themeli. Sa më i fortë të jetë themeli, aq më e qëndrueshme është ndërtesa. Ia vlen të investojmë për themele të qëndrueshme, jo vetëm për sa i përket zhvillimit të shëndetshëm fizik, por edhe sa i takon zhvillimit psikologjik dhe moral të tij.

Pse është i rëndësishëm zhvillimi i hershëm i fëmijës? Përgjigja gjendet në arsyen gjithëpërfshirëse se ai është ndikim përcaktues për shëndetin dhe jetën e fëmijës. Në vitet e parë të jetës së fëmijës ka disa gurë kilometrikë kyçë, ka periudha të ndjeshme për sa i përket zhvillimit biologjik dhe zhvillimit të trurit. Para se fëmijët të arrijnë moshën e shkollës, tek ata ndodhin një sërë ndryshimesh shumë të mëdha për sa i përket mundësive të tyre për të zhvilluar aftësitë bazë të cilat do të sjellin suksesin në vitet e mëvonshme. Në të gjithë dimensionet, qoftë në atë fizik, social, emocional, zhvillimin e gjuhës dhe atë njohës, vitet e hershme të jetës së fëmijës janë thelbësorë për shëndetin, mirëqenien fizike, të mësuarit dhe sjelljen në vitet që pasojnë.

NEVOJAT PSIKOLOGJIKE TË FËMIJËVE 0-6 VJEÇ

Rritja e shëndetshme e fëmijës duhet të shoqërohet me plotësimin e disa nevojave psikologjike. Për të kuptuar dhe nxitur zhvillimin e fëmijës, duhet të kuptojmë nevojat e tij psikologjike.

Vitet e para të jetës së fëmijës janë kritikë për zhvillimin e tij të mëvonshëm. Tre vitet e parë të jetës përfaqësojnë periudhën e zhvillimit dhe rritjes më të shpejtë të sistemit nervor. Pikërisht, në këta tre vitet e parë të jetës, foshnjat kanë më tepër nevojë dhe janë më të varur prej prindërve përsa i përket lidhjes me ta. Çdo dështim për të plotësuar nevojat bazë të fëmijëve, gjatë kësaj periudhe, mund të rezultojë në rrjedhoja të rënda, duke përfshirë shëndet të dëmtuar, funksionim të dobët senso-motor, kapacitet intelektual nën normalen dhe aftësi të dëmtuara për të krijuar marrëdhënie pozitive dhe jetëgjata. Nga nevojat psikologjike, ajo që është primare dhe tepër e rëndësishme, është dashuria e prindërve, dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes, por veçanërisht ajo e nënës.

Dashuria

Mbështetja emocionale dhe dashuria e prindërve stimulojnë rritjen mendore dhe fizike të fëmijës. Nevoja për të qenë i dashur nga të tjerët është thelbësore për zhvillimin e shëndetshëm psikologjik. **Prindërit të cilët shfaqin ngrohtësi dhe dashuri, nxitin ndjenjën e sigurisë tek**

fëmijët e tyre, e cila nuk mund të fitohet askund tjetër jashtë shtëpisë, apo me asnjë lloj mënyre tjetër. Fëmijët, që nuk e zhvillojnë këtë ndjenjë sigurie, shpesh shfaqin probleme të ndryshme anormale në përshtatjen me situatat e përditshme, duke iu bërë jeta e vështirë dhe, shpesh, kjo çon në keqformim emocional në jetën e të rriturit. Psikologët këshillojnë: **Reduktoni ndarjen nga prindërit në tre vitet e parë të jetës.** Ndarjet e zgjatura nga prindërit mund të shkaktojnë ndjenjën e pasigurisë tek fëmija. Ndarjet e rralla dhe të shkurtra, ku për fëmijën përkujdeset një person i afërt, janë të dobishme. Është e këshillueshme që deri në tre vitet e parë të jetës, të mos ketë ndarje për një kohë të gjatë nga nëna.

Fëmijët përjetojnë emocione të ndryshme në periudhën e fëmijërisë. Ata provojnë gëzim e dhembshuri, zemërim e zhgënjim, trishtim e turp, frikë e ankth, besim, kënaqësi dhe krenari. Ndjenjat pozitive si lumturia dhe besimi, u krijojnë fëmijëve një ndjenjë sigurie dhe i nxitin ata t'i përsërisin përvojat e kënaqshme. Ndjenjat negative krijojnë një gjendje jo të mirë, që shkakton pakënaqësi.

Atashimi

Atashimi është lidhja e thellë dhe jetëgjatë midis fëmijës dhe nënës në vitet e parë të jetës. Ai ndikon thellësisht çdo aspekt të jetës së fëmijës: mendjen, trupin, emocionet, marrëdhëniet dhe vlerat. Ai nuk është diçka që prindërit ua bëjnë fëmijëve të tyre, përkundrazi, është diçka që prindërit dhe fëmijët e krijojnë së bashku në një marrëdhënie të vazhdueshme të ndërsjelltë. Ai është një nga nevojat psikologjike thelbësore. Fëmijët janë instiktiv-

isht të prirur të atashohen; ata kërkojnë instiktivisht sigurinë dhe mbrojtjen e prindërve të tyre. Po kështu, edhe prindërit instiktivisht i mbrojnë dhe i edukojnë fëmijët e tyre. Atashimi është një fenomen fiziologjik, emocional, njohës dhe social. Sjelljet instiktive atashuese të fëmijës aktivizohen nga sjelljet e prindërve. Ndaj ai është përkufizuar si një sistem rregullator i ndërsjelltë, fëmija dhe prindi që e ndikojnë njëri – tjetrin me kalimin e kohës.

Besimi - Që nga foshnjëria deri sa bëhen 3 vjeç, fëmijët kalojnë dy faza të rëndësishme: **Krijimi i besimit dhe pavarësia.**

Në muajt e parë të jetës foshnjat krijojnë një ndjenjë bazë sigurie e besimi, ose në të kundërtën, ndihen të pasigurt dhe të pasigurt. Nëse fëmijët nuk i krijojnë ndjenjat e besimit në këto kohë, është shumë më e vështirë t'i krijojnë ato më vonë. Ndjenjat e sigurisë dhe të besimit krijohen në marrëdhëniet me të tjerët, nga mënyra se si trajtohen nga të tjerët; ato s'mund të krijohen vetvetiu. **Gjatë vitit të parë të jetës, stadi që e shoqëron këtë moshë është “besimi kundrejt mosbesimit”.** Duke qenë se foshnjat varen plotësisht nga të tjerët, ato shpresojnë se do të ndihmohen dhe asnjëherë nuk do të dëmtohen. Në qoftë se jeta e një fëmije 0-1 vjeç është e pasigurt, tek ai do të zhvillohet frika dhe mosbesimi ndaj të tjerëve.

Pavarësia – Marrëdhënia e varësisë që formon foshnja me nënën bëhet në mënyrë paradoksale baza për pavarësinë e ardhshme të fëmijës. Mbështetja e pavarësisë dhe inkurajimi nga prindërit janë vendimtare për zhvillimin personal dhe social të fëmijës. Studiuesit kanë arritur në përfundimin se fëmijët sillen më mirë dhe në mënyrë më

frytdhënëse nëse ata e ndjejnë se sjellja e tyre e ka burimin nga vetja. Gjatë vitit të 2-të të jetës, fëmijët që kanë të zhvilluar një ndjenjë të fortë besimi, fillojnë të kenë një pavarësi më të madhe. Fëmijët e pavarur bëjnë atë që mundin për veten, ata do të përfitojnë nga drejtimi që do t'u japin të tjerët, ndërkohë që do të ruajnë disa ide të tyre të pavarësisë. Kur të tjerët janë kritikues, fëmijët krijojnë në mendje dyshime lidhur me pavarësinë. Fëmijët që janë shumë të varur, dyshojnë në aftësinë e tyre për të kontrolluar botën që i rrethon, ose vetveten dhe mbështeten tek të tjerët për të marrë vendime e për të kryer veprime për ta. Për një zhvillim emocional sa më optimal, fëmijët kanë nevojë për ngrohtësi, përgjegjësi, dhe respekt në mënyrë që të nxitet vetëbesimi tek ta.

Siguria: Pasojat e çregullimeve të atashimit gjatë dy viteve të para të jetës mund të jetë dështim për të zhvilluar ndjenjën e sigurisë dhe besimit në marrëdhënie me të tjerët. Riktheni ndjenjën e rrënuar të sigurisë tek fëmija dhe mbrojeni atë, sa më shumë që të jetë e mundur, sepse fuqitë dhe aftësitë personale të fëmijës, me vite të tëra janë të pamjaftueshme që të kujdeset për vete, prandaj atij i nevojitet kujdesi i gjithanshëm i të rriturve. Ndjenja se ai është i dashur, i sigurt dhe i mbrojtur, është e domosdoshme për zhvillimin e drejtë të fëmijës.

Vëmendja: Të gjithë fëmijët kanë nevojë për vëmendje. Ata mund të bëjnë pothuajse gjithçka për të tërhequr vëmendjen tonë. Sikur t'u jepej mundësia të zgjidhnin, fëmijët do të dëshironin vëmendje nga ana e prindërve në një mënyrë pozitive, për shembull, me fjalë vlerësimi, lavdërimi ose dashurie. Fëmijët preferojnë më mirë të qortohen,

se sa të mos marrin asnjë lloj vëmendje prej prindërve. **Vëmendja dhe përfshirja e nënës** kërkohen patjetër si një sistem mbështetës bazë, që do t'i shërbejë fëmijës kur ai mëson të plotësojë nevojat e atyre që ka përreth. Pa këtë bazë mbështetëse, njeriu mund t'i drejtohet dhunës dhe kapitullimit: dhunës nga nëna, si pasojë, kapitullim të fëmijës, apo e anasjellta. Ju duhet t'iu kushtoni vëmendje fëmijës tuaj. Kur ju nuk ia vini veshin ai do të sillet negativisht që të tërheqë vëmendjen tuaj.

Pranimi: Fëmija ndihet i lumtur kur ai pranohet nga prindërit e tij. Pranojeni fëmijën ashtu siç është, pa kushte.

Respekti: Fëmija ka nevojë të ketë respekt për veten dhe të respektohet nga të tjerët. Kur fëmija juaj nuk e respekton veten dhe nuk merr respekt prej të tjerëve, vetëvlerësimi i tij do të jetë i ulët dhe ai do të ndihet i pashpresë dhe poshtë shpirtërisht. Gjëja më e keqe që do t'i ndodhë atij është se nuk do të ketë besim dhe shpresë për jetën. Lavdërojeni fëmijën sa herë që ai bën diçka të mirë, sepse kjo do t'ia rritë vetëvlerësimin.

Të ndjerit i aftë: Fëmijët kanë nevojë të ndjejnë se ata janë të aftë. Aftësia është forca shtytëse që fshihet prapa motivimit tonë për të kryer një detyrë të caktuar. Ata kanë nevojë të provojnë dhe të gabojnë, në mënyrë që të mësojnë. Atëherë ata do të ndihen të aftë dhe do të përjetojnë një ndjenjë arritje. Nëse ne ua bëjmë gjithçka gati atyre dhe nuk i lejojmë të provojnë dhe të gabojnë, ne, në fakt, po u dërgojmë atyre mesazhin se ata janë të paafët të bëjnë diçka vetë. Ky mesazh do të ketë pasojë negative mbi vetëvlerësimin e tyre dhe mund t'i shkurojë ata të provojnë veten në të ardhmen.

Përkatësia: Gjatë 5 viteve të para të jetës fëmija krijon identitetin e tij brenda familjes. Ajo çka është më e rëndësishmja për ta është të kuptojnë rolin e tyre brenda saj. Prindi duhet t'i kushtojë vëmendje **nxitjes së individualitetit** të fëmijës, që ndihmon për të përcaktuar kufijtë brenda të cilëve zhvillohet lëvizja e fëmijës jashtë shtëpisë.

Çdokush shpreson të jetë pjesë e një grupi. Ai do të ketë vendin e tij një shoqëri. Nëse ai refuzohet apo anashkalohet kjo të ndikojë zhvillimin e tij të shëndetshëm.

Marrëdhënia nënë - fëmijë

Atashimi është formimi i lidhjeve emocionale të qëndrueshme midis nënës dhe fëmijës. Kjo lidhje emocionale fillon të zhvillohet që prej ditëve të para pas lindjes. Kulmin e arrin diku në moshën prej 18 deri 30 muajsh të jetës së fëmijës. Ai është një proces që ndodh me kalimin e kohës dhe përfshin një marrëdhënie reciproke afeksioni midis tyre. Në periudhën 6-8 muajsh, kur foshnjat shohin një të panjohur, hidhen në krahët e nënës dhe nuk ndahen prej saj. Në këtë periudhë, ato përjetojnë atë që quhet ankthi, apo frika nga i huaji. **Në moshën 18 muajsh - 2 vjet ato përjetojnë ankth kur nëna nuk është aty.** Shfaqja e këtij ankthi sugjeron se foshnjat kanë një të kuptuar të qartë të faktit se nëna ekziston, edhe pse nuk është aty.

Foshnjat kanë nevojë të lidhen me të tjerët për zhvillimin e tyre psikologjik dhe social, po aq sa edhe për

mbijetesën e tyre. Ato kanë nevojë të jenë fizikisht afër me nënën e tyre dhe të marrin dhe të japin dashuri për të formuar një lidhje emocionale jetëgjatë. Fëmijët kanë nevojë të ndjejnë se ata janë të sigurt, se nuk do të braktisen, se ata duhen dhe vlerësohen.

Marrëdhënia unike dhe e pashoqe midis nënës dhe fëmijës ngjyros marrëdhëniet e tjera të fëmijës për gjithë jetën e tij. Teoria e atashimit pohon se marrëdhënia e hershme mes nënës dhe fëmijës është baza për gjithë formimin e personalitetit të fëmijës. Siguria e vendosur në një marrëdhënie të qëndrueshme me një person nga i cili mund të varet foshnja në zhvillim, sipas kësaj teorie, është thelbësore në krijimin e ndjenjës për vetveten dhe identitetin të domosdoshme për zhvillimin normal të karakterit. Nëse kjo marrëdhënie është e afërt dhe e sigurt, atëherë fëmija mëson Besimin dhe Dashurinë. Nëse kjo marrëdhënie është emocionalisht e largët dhe e paqëndrueshme, atëherë fëmija mëson të mos besojë dhe beson se është i vetëm në botë.

Nëse një fëmijë është i lidhur në mënyrë të sigurt apo jo me nënën e tij është provuar se është tregues i qartë i arritjeve në shkollë, i sjelljes së fëmijës, vetëvlerësimit të tij, aftësisë sociale, dhe aftësisë për të patur marrëdhënie me të tjerët.

Ai është gjithashtu i lidhur me probabilitetin e sëmundjeve mendore që mund të shfaqen në të ardhmen. Simptomat e një atashimi të çrregullt përfshijnë ndarje emocionale të deklaruar me gojë dhe një tërbim të brendshëm të pakontrollueshëm. Sipas psikologes kliniciste **Selma Frailberg**: “Çrregullimi i atashimit në fillim e çon fëmijën

në dëshpërim, i cili pasohet nga një pikë ku fëmija pushon së qeni i atashuar me të rritur të tjerë në ambientin e tij. Me kalimin e viteve, fëmija nuk është në gjendje të formojë marrëdhënie që zgjasin.”

Në çdo situatë që fëmijët përjetojnë dashurinë e prindërve të prerë në mes (p.sh. divorc, braktisje, dhunë, lënie pas dore, **përkujdesje me orar**, apo dashuri me kushte, bëj si them unë të të dua) kjo lidhje emocionale thyhet. Fëmijët më pas ndjejnë se janë të padashur nga të tjerët, sikur një pjesë e tyre është mbytur, apo ka vdekur. Ashtu si lidhja me nënën është nevoja jonë bazë, izolimi prej saj është gjendja më e dëmshme.

Shkaku kryesor i paaftësisë së njeriut për të dashur të tjerët, është pikërisht kjo gjendje e fëmijërisë, ku ata ndjejnë se të tjerët nuk i duan, gjendje që vazhdon të zgjasë edhe në moshë të rritur. **Dr. John Townsend** thotë në librin e tij, **“Fshehja nga Dashuria”**, se çrregullimet e atashimit kanë një emërues të përbashkët: mungesën e lidhjes në marrëdhëniet e rëndësishme të njeriut. Meqenëse Zoti na krijoi ne për t’u lidhur me njëri – tjetrin, kjo është pjesë e jetës sonë. Nëse ne nuk lidhemi në marrëdhënie të ngrohta, atëherë do të lidhemi me diçka tjetër, që nuk është kaq e dashur. **Pikërisht këtu qëndron rrënja e procesit të dhënies pas diçkaje tjetër. (mania, pasionet e kota)**

Deborah Hage, një terapiste e specializuar në çrregullimet e atashimit, thotë: “Tradicionalisht kemi besuar se fëmijët që kanë mbetur jetimë, apo janë dhunuar dhe lënë pas dore, janë viktimat e para të atashimit të dobët në vitet e para të jetës. **Sidoqoftë, në shoqërinë tonë dy-rrogëshe (burri dhe gruaja) ka dalë një fenomen i ri. Fëmijëve u**

plotësohen të gjitha tekat dhe dëshirat nga prindërit, të cilët kanë më shumë para, se sa kohë për të kaluar me ta. Rezultati është se, fëmijët po rriten në një ambient të sigurt financiarisht, por emocionalisht të zbrazët, pa disiplinë dhe organizim. Fatkeqësisht, në ditët e sotme kjo formë më e zakonshme e neglizhimit, apo lënies pas dore, është më e pranueshme në shoqëri. Shtimi i madh i numrit të fëmijëve, të cilëve u plotësohen të gjitha tekat dhe braktisen emocionalisht, mund të jetë po aq e rëndë sa edhe te fëmijët të cilët kanë probleme me atashimin, për shkak të dhunës, lënies pas dore dhe ndërrimit të shpeshtë të ambientit të tij.”

RËNDËSIA E MARRËDHËNIES NËNË - FËMIJË

Marrëdhënia nënë-fëmijë, duke qenë se është marrëdhënia më e ngushtë, më intensive dhe më ndikuese, është e pashoqe. Nëna ka një ndikim përcaktues dhe jetëgjatë mbi karakteristikat psiko-sociale të fëmijës gjatë procesit të edukimit. Forca, thellësia dhe vazhdimësia e atashimit do të mjaftonin për të shpjeguar ndikimin përcaktues të nënës.

Për të përshkruar rëndësinë e atashimit do të thoshim se është i një rëndësie jetike për fëmijën, sepse ai mund të ndikojë zhvillimin psikologjik dhe social të fëmijës. Kërkimet shkencore kanë treguar se fëmijët, të cilët kanë qenë të lidhur ngushtë me nënën në foshnjëri, rriten duke qenë më të sigurt në disa shprehje sociale dhe njohëse: ata janë më kuriozë, bashkëpunojnë më shumë me të tjerët, janë më të aftë, më të prirur për të marrë ven-

dime dhe për t'u vetëudhëhequr, më të pavarur se sa ata që kanë patur atashim të dobët. Ata, gjithashtu, janë të prirur të kërkojnë për shoqëri nga të tjerët dhe të zgjidhen për t'u bërë udhëheqës. Në shkollë, ata ndërveprojnë me mësuesit në mënyrë miqësore dhe të përshtatshme, ka më shumë të ngjarë të jenë më të pavarur, dhe u kërkojnë ndihmë mësuesve vetëm atëherë kur duhet. Janë më të aftë për të zgjidhur problemin, më kureshtarë në moshën parashkollore, shprehin më shumë afri për lojërat simbolike, më shumë entuziazëm në lojë, kanë tendencë të reagojnë më shumë kur nëna afrohet dhe ngjiten pas saj, dhe, gjithashtu, janë më pak agresivë.

Përkundrazi, fëmijët që kanë patur një atashim të dobët janë më të prirur për të përjetuar më shumë vështirësi në këto fusha dhe këto pasoja mund të mbarten edhe në vitet që pasojnë. Është zbuluar se atashimi i dobët është një nga faktorët në ekuacionin që shpjegon problemet që shfaqen në adoleshencë, të tilla si: kriminaliteti, shtatzania në adoleshencë, përdorimi i drogës dhe alkoolit, e të tjera.

Rëndësia e madhe e atashimit së nënës me fëmijën shihet edhe në faktin se, faza më e efektshme edukative në transmetimin e kulturës tek brezi i ri është periudha intensive e të mësuarit gjatë fëmijërisë, kur fëmija përjeton marrëdhënie fytyrë më fytyrë në atmosferën emocionale të familjes. (periudha 0-6 vjeç)

Ç'janë çrregullimet e atashimit?

Jay Belsky

Çrregullimet e atashimit i karakterizon mungesa apo çrregullimi i lidhjes që zhvillohet normalisht midis nënës dhe fëmijës. Ato vijnë si rezultat i kujdesit të pamjaftueshëm, apo të pakënaqshëm në fëmijërinë e hershme. Vlen të theksohet se, çrregullimet e atashimit ndikojnë negativisht në zhvillimin e ndjenjave të dashurisë së fëmijës ndaj të afërmeve të tij. Nëse, për rrethana të caktuara, shkohet deri tek mungesa e lidhjes emocionale në moshë të hershme, kjo nuk i mundëson fëmijës që të krijojë vetërespekt pozitiv apo vetëvlerësim, aftësi sociale si dhe ndjenjën e sigurisë tek tjetri. **Jay Belsky** është ndër psikologët më të njohur që është marrë me çështjen e atashimit dhe çrregullimeve të tij si dhe me një sërë studimesh në lidhje me rritjen e fëmijëve në çerdhe. Ai mendon se shkëputja e herëpashershme e fëmijës nga nëna në periudhën e foshnjërisë së hershme, le pasojat e saj, të cilat ndikojnë në procesin e atashimit, apo lidhjes me fëmijën. **“Faktet tregojnë,” - thotë Prof. Belsky, se: kujdesi i hershëm dhe e zgjatur jomëmësor shoqërohet me marrëdhënie joharmonike prind - fëmijë dhe nivele të ngritur të agresivitetit dhe mosbindjes. (Belsky 1986, 1988, 1990)**

Winicot (psikanalist anglez) në punimin e tij ontologjik **“Preokupimi i parë i nënës”**, dëshmon se çdo mungesë e kujdesit të nënës në periudhën e hershme fëmija e përjeton si rrezik për ekzistimin e vet. Winicot

në literaturën studimore shkencore solli termin “mbajtje” e fëmijës si term i veçantë, që i përket gjithanshmërisë së kujdesit të nënës në moshën kur fëmija është në varësi fizike dhe psikologjike nga ajo. Winicot thekson se “mbajtja” si nocion përfshin mbajtjen fizike të fëmijës, të cilën e quan si formë e dashurisë. Ka nëna që mund ta mbajnë fëmijën, dhe të tjera që nuk mund ta mbajnë. Këto të dytat, tek fëmija krijojnë ndjenjën e pasigurisë dhe qarjes së dhimbshme.


ZHVILLIMI I TRURIT TEK FËMIJËT 0-2 VJEÇ

Eksperienca ndërton arkitekturën e trurit

Eksperienca e fëmijërisë në vitet e para të jetës le pasojë afatgjatë në arkitekturën e trurit. 90% e zhvillimit të trurit të fëmijës ndodh në tre vjeçarin e parë të jetës.

Gjenet janë ato që japin kornizën bazë, por eksperienca është ajo që i jep formë këtij procesi duke përcaktuar kësh-tu, nëse truri i fëmijës do të japë gjithë bazën e nevojshme për gjithë të mësuarit, sjelljen dhe shëndetin që do të pasojnë në vitet e ardhshme të jetës së fëmijës. Gjatë kësaj periudhe shumë të rëndësishme në zhvillimin e trurit të fëmijës, biliona qeliza të trurit të quajtura neurone, dërgojnë sinjale elektrike për të komunikuar me njëra –tjetrën. Këto lidhje formojnë qarqe, të cilat bëhen themeli bazë i arkitekturës së trurit. Qarqet dhe lidhjet midis qelizave nervore shumohen me një shpejtësi të madhe dhe përforcohen nëpërmjet përdorimit të përsëritur apo të për-


forcuar. Eksperienca jonë dhe ambienti përcaktojnë se cilat lidhje do të përdoren më tepër. Ato lidhje që përdoren më shumë forcohen dhe bëhen jetëgjata, ndërsa ato që përdoren më pak, zbehen dhe zhduken nëpërmjet një procesi që quhet “krastitje.”



Lidhjet nervore tek foshnjat në lindje, 15 muajsh dhe 2-3 vjeç

Qarqet që përdoren më tepër krijojnë rrugëza të shpejta në mënyrë që sinjalet nervore të udhëtojnë më shpejt përmes trurit. Qarqet e thjeshtë përbëjnë bazën për ata më të ndërlikuarit, të cilët do të ndërtohen më vonë. Nëpërmjet këtij procesi, neuronet formojnë qarqe dhe lidhje më të forta për emocionet, shprehitë motorike, logjikën dhe gjuhën, kujtesën dhe kontrollin e sjelljes përgjatë periudhës së hershme kritike për zhvillimin e fëmijës. Me anë të përdorimit të shpeshtë, këto lidhje behen më frutdhënëse dhe i lidhin pjesët e ndryshme të trurit më shpejt. Qarqet nervore janë të ndërlidhur midis tyre. Nuk mund të kemi një tip aftësie pa pasur tjetrin për ta mbështetur atë. Ky

proces mund të krahasohet me ndërtimin e një shtëpie, ku gjithçka lidhet me tjetrën dhe ato që vijnë të parat përbëjnë bazën për gjithçka që do të vijë më vonë.



Në zhvillimin e trurit ka disa periudha që quhen periudha të ndjeshme. Siç shihet edhe nga kurbat e grafikut, të gjitha aftësitë e arrijnë kulmin e tyre në moshën 2-3 vjeç.

Marrëdhënia nënë - fëmijë i jep formë qarqeve të trurit të fëmijës

Çelësi për të formuar një arkitekturë të qëndrueshme të trurit tek fëmijët gjendet në atë që quhet dialog, dhënie dhe marrje. Në këtë “lojë” zhvillimore në trurin e fëmijës formohen lidhje të reja nervore gjatë kohës kur foshnjat në mënyrë instiktive marrin pjesë në këtë dialog sjellor nëpërmjet belbëzimeve, shprehjeve të fytyrës dhe gjesteve, ndërsa nëna u përgjigjet atyre në mënyrë shumë të drejtpërdrejtë dhe kuptimplotë. Kjo lojë sjellore nis shumë

herët në jetën e fëmijës, kur ai guget dhe ajo ndërvepron me të dhe ia tërheq vëmendjen drejt fytyrës apo dorës së saj.

Është pikërisht kjo marrëdhënie e cila formon bazën e trurit, mbi të cilën do të ndërtohet i gjithë zhvillimi i mëtejshëm në jetën e fëmijës. Kjo marrëdhënie ndihmon në krijimin e lidhjeve të reja nervore midis gjithë zonave të ndryshme të trurit duke ndërtuar aftësitë emocionale dhe njohëse për të cilat fëmijët kanë nevojë përgjatë gjithë jetës. Çdo fazë në zhvillimin e trurit të fëmijës ndërtohet mbi bazën e asaj që ishte më parë.

Gjatë 2 viteve të para të jetës së fëmijës, siç e përmendëm edhe më lart, qelizat e trurit lidhen me njëra – tjetrën duke prishur lidhjet që nuk përdoren dhe duke përforcuar ato lidhje që përdoren më tepër, me fjalë të tjera duke i dhënë formë strukturës së trurit. Kur lind fëmija, vetëm një pjesë e trurit është plotësisht e zhvilluar, palca e zgjatur - pjesa fundore e trurit që lidhet me shtyllën kurrizore . Ajo ka të bëjë me funksionet bazë të jetës përfshi këtu reflekset për mbijetesë. Në vitin e parë të jetës së fëmijës pjesët më të rëndësishme të trurit në zhvillim janë ato që kanë të bëjnë me funksionet social – emocionale, të cilat e kanë rrënjën në marrëdhënien e atashimit.

Në moshën 10 – 12 muajsh, që është pikërisht periudha kur procesi i atashimit është në pikën kritike të tij, fillojnë të formohen zonat prefrontale. Bebet dhe fëmijët 0-3 vjeç mund të formojnë vetëm disa marrëdhënie të ngushta me përkujdesësit e tyre dhe, për ta bërë këtë është thelbësore për ta që të kenë marrëdhënie të vazhdueshme vetëm me një përkujdesës.

Duke bërë të mundur që fëmijët të kenë përkujdesëset nëna, të cilat janë figura të qëndrueshme, të cilat vazhdimisht angazhohen në një dialog sjellor, dhënie dhe marrje që fillon që në foshnjëri, kjo ndërton bazën për gjithë të mësuarit, sjelljen dhe shëndetin që do të pasojnë në vitet e ardhshme.



Atashimi dhe hemisfera e djathtë e trurit

Dr. Allan Schore PhD – neurobiolog dhe psikoterapist, i cili është quajtur Ajnshtajni i neuroshkencës

Teknologjia e re e skanimit të trurit ka dhënë depërtime në thellësi të trurit të fëmijës, të cilat janë tronditëse përse i përket funksionimit dhe zhvillimit të trurit dhe rolit jetësor që luan eksperiencia në strukturën e trurit të fëmijës. Një nga rolet kryesore të lobit të djathtë frontal është kodimi i informacionit afektiv (që ka të bëjë me emocionet), kjo do të thotë se ajo i jep eksperiencave një ngjyrim personal të domosdoshëm për humorin, ndërgjegjjen dhe memorjen apatike (të fjetur). Hemisfera e djathtë është

përgjegjëse për funksionet emocionale dhe sociale dhe për përpunimin e informacionit social – emocional. Hemisfera e djathtë është dominante për atashimin, rregullimin e stresit, dhe komunikimin joverbal. Aftësitë unike të hemisferës së djathtë, dhe jo asaj të majtë, qëndrojnë në faktin se ajo ruan “fjalorin” e komunikimit joverbal afektiv, si psh. shprehjet e fytyrës, me një fjalë, sistemin e atashimit dhe kodon memorjen procedurale implicite (të pashprehur me fjalë) dhe jo atë semantike, deklarative. Ajo jep një model të brendshëm veprues marrëdhënies së atashimit me nënën që kodon strategjitë e rregullimit të emocioneve që do t’i përdorë individi përgjatë gjithë jetës së tij.

Shabllonet e marrëdhënies së atashimit me nënën “printohen” apo “digjen” në lobin e djathtë ballor. Janë pikërisht këto marrëdhënie të cilat “farkëtojnë” lidhjet midis qelizave hemisferës së djathtë të trurit të fëmijës. Me një fjalë, marrëdhënia e atashimit i jep formë maturimit të hemisferës së djathtë, formë e cila varet nga eksperiencia. Thënë ndryshe, mekanizmi i atashimit bën më tepër se sa vetëm ndikimin e psikologjisë së fëmijës në zhvillim, ai gëdhend vetë lëndën e trurit. Gjithashtu ndikon qarqet e trurit që janë në zhvillim gjatë asaj kohe. Hemisfera e djathtë, e cila zhvillohet më herët tek foshnjat, ka lidhje të thella me sistemin limbik dhe autonom dhe është përgjegjëse për përgjigjen ndaj stresit dhe në këtë mënyrë marrëdhënia e atashimit lehtëson zgjerimin e kapaciteteve që ka fëmija përsa i përket përballjes me stresin.

Hemisera e djathtë gjithashtu bëhet dominante për empatinë, e cila është aftësia për të kuptuar gjendjet shpirtërore të njerëzve të tjerë dhe për të “lexuar” qëllimet e tyre. Kjo realizohet në nivelin e të pandërgjegjshmes.

Psikologët Fineberg & Kinen, të cilët janë marrë me studimin e hemisferës së djathtë, kanë arritur në përfundimin se pjesa ballore e hemisferës së djathtë, në situata normale, luan një rol kritik në themelimin e marrëdhënieve të drejta midis vetes dhe botës.

Marrëdhënia e atashimit me nënën rregullon direkt gjenomin e fëmijës

Dr. Allan Schore PhD

Neurobiologu dhe psikoterapisti i njohur amerikan **Allan Schore** në ligjëratën e tij me titull: **“Neurobiogjia e atashimit të sigurt”** shpjegon qartë se: **Ndërveprimi i parë midis gjeneve dhe ambientit gjendet në marrëdhënien psiko-biologjike midis nënës dhe fëmijës.**


Një nga idetë më të gabuara që kanë shkencëtarët është se: “Gjithçka që është para lindjes së fëmijës është gjenetike dhe gjithçka tjetër pas lindjes është e mësuar. Kjo nuk është e vërtetë. Në koren e trurit të fëmijës ka më shumë material gjenetik në periudhën 10 muajsh të jetës, shumë më shumë se pas lindjes së fëmijës. Çfarë do të thotë ky fakt? Kjo do të thotë se gjenet janë duke programuar mjaft mirë në vitin e parë të jetës; ato nuk ndalojnë pas lindjes dhe ato gjene që kodojnë lidhjet midis pjesëve të trurit që do zhvillohen më vonë, janë në gjendje shumë aktive.

Truri i foshnjës, që nga tremujori i fundit i shtatzanisë deri në fundin e vitit të 2-të jetës, pëson një rritje shpër-

thyese, sepse dyfishohet në përmasë. Ai formon lidhjet midis neuroneve, por maturimi i trurit të foshnjës varet nga eksperiencia së cilët ai apo ajo i nënshtrohet. Nuk është se gjenet do të shpalosen dhe gjithçka do të lulëzojë vetë, si bima. Jo! Trurit i duhen disa lloj eksperiencash në mënyrë që të zhvillohet. **Pjesët më të rëndësishme të trurit që duhet të zhvillohen në vitin e parë të jetës janë ato që përfshihen me jetën emocionale dhe sociale të fëmijës, të cilat e kanë themelin në marrëdhënien e atashimit me nënën.** Me qëllim që të zhvillohen, këto pjesë të trurit nevojiten disa lloj eksperiencash, dhe këto eksperiencia e kanë bazën në marrëdhënien midis nënës dhe foshnjës. Nëse ato janë pozitive, nëse janë të ngrohta, atëherë do të kemi një situatë optimale.

Truri i foshnjës nuk vazhdon të rritet e të rritet. Ai organizohet dhe çorganizohet dhe riorganizohet përsëri dhe ky çorganizim i trurit, që do të thotë vdekja masive e biliona qelizave dhe prishja e lidhjeve sinaptike, që është pjesë e zhvillimit të trurit. Ato lidhje që nuk përdoret vdesin apo prishen. Kjo është arsyeja pse këtu është pikë kritike për fëmijën një ambient i pasur e i ngrohtë emocional.

Por mund të kemi edhe rastin e një marrëdhënie atashimi të pasigurt me nënën. Kjo është periudha kur truri po i nënshtrohet zhvillimit të madh strukturor dhe lidhjet që po bëjnë qelizat nervore në këtë periudhë do të ndikojnë gjithë shabllonet e fëmijës për të krijuar marrëdhënie në të ardhmen.



Kjo foto tregon skanimin e trurit të dy fëmijëve 3 vjeç. Fotoja në të djathtë tregon trurin e fëmijës që është neglizhuar mjaft. Truri është në përmasë më të vogël dhe ka hapësira më të mëdha krahasuar me fëmijën tjetër që ka patur marrëdhënie të ngrohta me nënën.

Ka një prirje të fortë përta i përket cilësisë së marrëdhënies me përkujdesësin kryesor të foshnjës që të bëhet modeli veprues i brendësuar dominant dhe jetëgjatë gjatë kohës që fëmija është duke u rritur.

Sistemet gjenetike që kodojnë lidhjet e pjesës së epërme të trurit, të cilat përfshihen me funksionet socio-emocionale, zhvillohen në moshën 10-12 muajshe. Këto gjene ndikohen nga hormonet që stimulohen në marrëdhënien midis nënës dhe fëmijës, sepse, kur nëna dhe fëmija janë përfshirë në një “vallëzim” harmonik, sistemet e tyre psikologjike rregullojnë reciprokisht njëri-tjetrin. Ne, po ashtu, dimë se kortisoli, që është hormoni i stresit, gjithashtu rregullon gjenet. Ajo që dua të them

me këtë thotë Prof. Allan Schore është se: **“Marrëdhënia e atashimit me nënën rregullon direkt gjenomin e fëmijës.** Kjo marrëdhënie rregullon mënyrën se si gjenet do të vazhdojnë së koduari proteinat. Pra, kjo shkon përtej idesë se çfarë është **prejardhja gjenetike** e çfarë është eksperiencia apo **edukimi**. Ato ndërthuren së bashku. **Ndërveprimi i parë midis gjeneve dhe ambientit dhe gjendet në marrëdhënien psiko-biologjike midis nënës dhe fëmijës.**

Gjithashtu Prof. Allan Schore thekson se: **Ngjarjet që ndodhin gjatë foshnjërisë, veçanërisht marrëdhëniet me ambientin social të fëmijës, shumë më tepër se sa marrëdhëniet me ambientin fizik printohen në mënyrë të pashlyeshme në strukturat që janë në maturim gjatë viteve të para të jetës së fëmijës.**

Gjdhënia dhe zhvillimi i trurit tek fëmija 0-2 vjeç

Allahu i madhëruar e ka përcaktuar në Kur'anin fisnik se gjdhënia për fëmijët duhet të jetë 2 vjet në suren Bekare, vargu 233. ***“Nënat le t’u japin gj fëmijëve të tyre 2 vjet, për ata që duan ta plotësojnë dhënien e gjirit... Por, nëse pas këshillimit ata vendosin me pëlqim të ndërsjelltë që ta ndajnë fëmijën nga gjiri, kjo nuk është gjynah për ata. Po ashtu nuk është gjynah për ju nëse doni t’i gjeni fëmijës tuaj ndonjë mëndeshë (gjdhënëse) me kusht që t’ia jepni atë që keni menduar sipas rregullave. Ta keni frikë Allahun dhe dijeni se Allahu i sheh mirë të gjitha punët që bëni ju.*** Gjithashtu, Ai ka thënë në po këtë varg:

“Asnjë nënë nuk bën të dëmtohet me fëmijën e vet e as babai me fëmijën e tij.”


Ato që përmendëm nuk janë gjë tjetër vetëm se vërtetim i këtyre ajeteve kur'anore. Allahu e përmend dëmin në fazën e gjidhënies pikërisht, sepse në këtë fazë zhvillohet truri i fëmijës dhe ai ka më së shumti nevojë fizike dhe psikologjike për nënën e tij. Gjidhënia është themeli mbi të cilin do të ndërtohet karakteri i fëmijës.

Sinkronizimi fytyrë më fytyrë

David Arredondo

Kur nëna dhe foshnja ndodhen përballë njëri-tjetrit duke bërë kontakt me sy, në trurin e fëmijës formohen me mijëra lidhje nervore në sekondë dhe në këtë mënyrë fëmija mëson të lexojë shprehjet e fytyrës. Ai kështu mëson për botën, mëson se bota rreth tij është e përgjegjshme. Ai mëson se mund t'i gëzojë të tjerët, se ai ka vlerë, etj. etj. Kjo marrëdhënie fytyrë më fytyrë është kritike për zhvillimin e fëmijës. **Sistemet pamore që lidhen** me strukturat e thella në trurin e fëmijës lidhen me **kontrollin emocional**. Kjo do të thotë se, fëmijët të cilët janë të rrethuar vetëm disa fytyra të qëndrueshme njerëzish, të cilët përjetojnë një shumëllojshmëri emocionesh, zhvillojnë aftësitë neurobiologjike për të deshifruar emocionet. Fëmijët të cilët lihen pas dore, apo rriten në ambiente të varfra emocio-

nalisht, apo të dhunshme, zhvillojnë një stil krejtësisht të ndryshëm të përballjes me jetën dhe një sistem lidhjesh biologjike, i cili nuk punon në mënyrë përshtatëse në vitet e mëvonshme.



FORMIMI I PERSONALITETIT TË FËMIJËS

Prof. Dr. Muhamed El-Mehdi

Personaliteti është “kompleksiteti i karakteristikave që e dallojnë një individ të veçantë, dhe (prirjet e tij) për të pasur marrëdhënie, për të perceptuar, për të reaguar, apo thënë ndryshe për të ndikuar apo përjetuar ambientin e tij.”

Stimujt e parë kanë një ndikim më të madh se sa ata të mëvonshmit, sepse ata kanë më pak Përvojë Totale të të Mësuarit, PTM, për ta fshirë efektin e tyre dhe ata kanë, po ashtu, ndikim me të madh tek fëmija, sepse janë shumë më influencues në përcaktimin e perceptimit të stimujve të ardhshëm nga ambienti. Kjo shpjegon edhe supozimin e njohur të teorive mbi personalitetin, që thonë se ai formohet në vitet e para të jetës së fëmijës. Nga ligjet e përgjithshme të zhvillimit të fëmijës Prof.Dr. Muhamed El-Mehdi thotë se: **Çdo ndikim në jetën e fëmijës ka një efekt më të madh se zero, dhe, në një kohë që, disa ndikime janë shumë të papërfillshëm, disa të tjerë mund të jenë aq të fuqishëm, sa të sjellin ndryshime në jetë.**

Disa përfundime nga shkenca e psikologjisë së zhvillimit të fëmijës 0-6 vjeç

Rezultatet e kërimit në fushën e shkencës së psikologjisë së zhvillimit tregojnë se: 2/3 e rritjes shumëdimensionale të qenies njerëzore (fizike, intelektuale, ndje-

sore, gjuhësore, sociale, individualiteti, etj), zënë vend gjatë periudhës së 6 viteve të para të jetës. Në këtë periudhë, ku rritja psiko-sociale e fëmijës është shumë e shpejtë, përcaktohen njëherë e përgjithmonë ravijëzimet e karakterit, personalitetit dhe sistemit të egos, të cilat përmbajnë kodet kryesore të sjelljeve që do të shfaqen përgjatë gjithë jetës së individit. **E si mund të jetë ky një proces që mund t'i lihet rastësisë?**

Atëherë ngrihet pyetja: Mbi ç'bazë po e ndërtojmë karakterin e fëmijëve tanë? Në moshën kur ata kanë më shumë nevojë dhe hedhin themelet e personalitetit të tyre, ne po ua lemë njerëzve të panjohur, pa asnjë lidhje familjare t'ua përcaktojnë rrugën e zhvillimit. Ne, si brezi i parë i të rinjve muslimanëve pas ringjalljes së besimit, na del për detyrë t'i studiojmë mirë këto fakte dhe të reflektojmë. Ajo që do të lemë ne si traditë do të ndiqet edhe nga fëmijët tanë.

PASOJAT E KUJDESIT DITOR NËPËR ÇERDHE E KOPSHTË MBI ZHVILLIMIN E PËRGJITHSHËM TË FËMIJËS

Historik i shkurtër rreth qendrave të kujdesit ditor (çerdhe e kopshte)

Qysh nga shekulli i kaluar nëpër botë është përhapur praktika e largimit të fëmijëve nga gjiri i familjes për shkak të punësimit masiv të nënave. Në këtë studim kam për qëllim të hedh dritë mbi disa fakte e të dhëna se si ndikon kjo eksperiencë e fëmijërisë së hershme mbi kara-

kterin dhe personalitetin e fëmijëve bazuar mbi kërkimet e psikologëve amerikanë.

Qendra e parë e kujdesit ditor u shfaq në Francë rreth vitit 1840 dhe u njoh me ligj nga qeveria franceze më 1869. Pasi u krijuan në Europë në fund të shek 18-të dhe në fillim të shekullit të 19-të, ato u përhapën në Amerikë nga organizatat private humanitare, prej të cilave, e para u hap në vitin 1854. Në vendin tonë ato janë një traditë e vonë që e mbolli komunizmi. Ngritja e çerdheve dhe kopshteve ishte një nga masat e politikës sociale të shtetit. Synimet e shtetit për edukimin e fëmijëve lindën direkt prej nevojave të ngritjes së shoqërisë socialiste. Qëllimi i masave që u morën në Shqipëri ishte krijimi i “personalitetit socialist”, që duhej të fillonte qysh në moshë të hershme. Fëmijët u panë si përthithës të gatshëm të edukatës komuniste, tek të cilët mund të kultivohej ajo. Ata duhet të përvetësonin sjellje të vetëdijshme racionale, të detyruara nga shoqëria dhe të përshtatura me të (modeli i kolektivizimit). “Barazia” midis burrave dhe grave kërkonte ngritjen e institucioneve të kujdesit ditor për fëmijët.

Dërgimi i foshnjave në çerdhe dhe në kopësht po përhapet si praktikë edhe midis nënave muslimane. Edhe ne sot këtë traditë po ndjekim, po ecim në “gjurmët e të parëve”. Në pamje të parë, duket sikur s’ka asgjë të keqe. Fëmijët atje mësojnë, luajnë me njëri-tjetrin. “E, çdo t’i mësoj unë në shtëpi” thonë nënat?” Ca të tjera i dërgojnë për t’u bërë më të “socializuar”. Le të shohim çfarë thonë rezultatet e studimeve shkencore bashkëkohore për gjurmët që gdhenden mbi zhvillimin e përgjithshmëm të fëmijës.

Pasojat e zgjatjes së këtij fenomeni mbi natyrën dhe drejtimin e gjithë shoqërisë sonë, nuk janë të dukshme direkt me pamje të parë. Shumica e prindërve e kuptojnë se vendimi se ku do ta sistemojnë fëmijën nën kujdesin e dikujt tjetër dhe zgjedhja për sa i përket llojit të çerdhes apo kopshtit, do të ndikojë punën e tyre dhe jetën e tyre familjare. Por, shumë pak prej tyre janë të vetëdijshëm se sa ndikon kujdesi i plotë ditor jetën e fëmijës së tyre. Për vite me rradhë, **ekspertët amerikanë të zhvillimit të fëmijës, me anë të studimeve të tyre, na kanë paralajmëruar për rrjedhojat shkatërruese të fëmijëve të vendosur nëpër institucione.** A do t'ia linit një të huaji makinën tuaj? Ka të ngjarë që jo. Ajo është një pronë e çmuar, që kushton sh-trenjt të riparohet, apo të blihet një e re në vend të saj. Nëse nuk ia lini një të huaji të marrë makinën tuaj për disa orë, atëherë, pse ia lejoni një të huaji të marrë në dorë fëmijën tuaj të vogël gjithë ditën, çdo ditë?

Nga fundi i viteve 1970 psikologët filluan të vëzhgojnë atashimin e fëmijëve, që ishin lënë nën kujdesin ditor të çerdheve dhe kopshteve. Studimet paralajmërojnë për një probabilitet më të madh të **atashimit të dobët me nënat** të foshnjave, të cilat janë lënë nën kujdes ditor para moshës 1 vjeç. Gjithashtu, ato nxjerrin në pah **vonesa për sa i përket zhvillimit njohës** tek fëmijët, po ashtu edhe **sjellje sociale të padëshirueshme**. Madje, disa psikologë filluan të mendonin nëse fëmijët duhet të sistemoheshin nën kujdesin ditor apo jo.

Instituti Kombëtar i Shëndetit dhe Zhvillimit të Fëmijës, (NICHD) në Amerikë, ka studiuar çerdhet e kopshtet për vite me radhë. Ja disa nga përfundimet e arritura nga ky institucion në vitin 2001, në studimin me titull "Realiteti i kujdesit ditor".

-Foshnjat që ndahen nga nënat e tyre për më shumë se 10 orë në javë qysh në moshë të hershme, s'ka rëndësi nëse janë me dado në shtëpinë e tyre, apo në qendra të kujdesit ditor, janë më agresivë sapo hyjnë në marrëdhënie me shkollën. Ata klasifikohen kështu nga nënat dhe mësueset e tyre.

-Ky segment, në këtë studim që është ende në vazhdimësi, ka arritur në përfundimin se: Një fëmijë nuk duhet të lihet në kujdesin ditor të më shumë se dy fëmijëve për një edukatore!

-NICHD ka raportuar më parë se gjysma e intervaleve kohore të kujdesit ditor janë kaq të varfëra, saqë përbëjnë një rrezik për zhvillimin intelektual, emocional dhe fizik të foshnjës.

-Kërkimet mbi atashimin nënë-fëmijë tregojnë se, foshnjat dëmtohen nëse largohen prej nënave të tyre për më tepër se 15 orë në javë. Ata zhvillohen mjaft mirë kur nëna është gjithmonë e pranishme.

-Kërkimet e ditëve të sotme mbi trurin e fëmijës të drejtuar nga Dr. Stanley Greenspan i Universitetit Xhorxh Uashington provojnë se: **Për të arritur një zhvillim optimal intelektual, fizik dhe emocional, foshnja ka nevojë vetëm për një person përkujdesës në tre vitet e parë të jetës. Më shumë përkujdesës nuk bëjnë dobi. Kjo, madje, është shumë e dëmshme për ndjenjën e sigurisë, aftësisë për të zhvilluar besim te të tjerët dhe zhvillimit intelektual të fëmijës.**

-Mjaft nënave u pëlqen të thonë se fëmijët e tyre shkoj-

në në çerdhe për t'u socializuar. Por, socializmi i foshnjave vjen nga prindërit dhe jo nga bashkëmoshatarët e tyre. **Penelope Leach**, specialiste e zhvillimit të fëmijës, shkruan se foshnjat e tjera **NUK I DUHEN** bebes tuaj në kujdesin ditor. Gjithashtu, ajo ka thënë: “Ndërrimi i edukatoreve nëpër qendra ka pasoja shkatërruese mbi fëmijën.”

Ndikimi i kujdesit ditor të hershëm mbi atashimin me nënën

Jay Belsky

Në studimin “**Rishqyrtim i pasojave të kujdesit ditor**” është treguar se: foshnjat nga 12-13 muajsh, që i nënshtrohen kujdesit ditor për më tepër se 20 orë në javë prej dikujt tjetër veç nënës, janë në rrezik për vështirësi psikologjike dhe të sjelljes. (Belsky, 1988). Gjithashtu, në artikullin e tij ai raporton se: foshnjat që i nënshtrohen kujdesit ditor janë më shumë të prirur të krijojnë një atashim të pasigurt me nënat e tyre kur testohen. Ky atashim i pasigurt shoqërohet me “agresivitet të lartë, kundërshtim, kokëfortësi dhe tërheqje në vitet parashkollëre dhe në vitet e para të shkollës.” Nga kjo, ai arriti në përfundimin se, kujdesi ditor i zgjatur, në vitin e parë të jetës, është në vetvete një faktor i rrezikshëm psikologjik.

Dr. Eleonor Galenson, një psikiatre e njohur për fëmijë nga Nju Jorku, është shprehur se e konsideron të dëmshëm kujdesin e plotë ditor për fëmijët dhe se raporti i Belskit thjesht konfirmonte atë që ajo shihte çdo ditë në praktikën e saj – fëmijë psikikat e të cilëve ishin dëmtuar

pjesërisht për shkak të mungesës së vëmendjes së nënës.
“Të lesh foshnjat me kohë të plotë në çerdhe” - thotë ajo
“është një praktikë e rrezikshme.”

Kujdesi Ditor lidhet me sjellje agresive, kokëfortësi dhe kundërshtim

Këto zbulime janë marrë nga Instituti Kombëtar i Shëndetit dhe Zhvillimit të Fëmijës (NICHD) Amerikë Korrik 2003

Sipas një studimi të vitit 2003, sa më tepër kohë që kalonin fëmijët nga foshnjëria deri në moshën 4 vjeç e gjysmë, aq më shumë të rriturit i klasifikonin ata, edhe në 4 vjeç e gjysmë, edhe në moshën e shkollës, si të prirur për sjellje jo të mira me të tjerët, kokëfortë, të pabindur dhe agresivë. Sipas këtij studimi, ndjeshmëria e nënës ndaj fëmijës ishte një tregues më pozitiv tek sjelljet problematike të raportuara, se sa koha e qëndrimit në qendrat e kujdesit ditor, çka tregonte se: **ndjeshmëria më e madhe e nënës ndaj fëmijës lidhet me më pak probleme në sjellje**. Gjithashtu, edukimi më i lartë i nënës dhe të ardhurat familjare më të mëdha parashikonin nivele më të ulëta të sjelljeve problematike tek fëmijët. NICHD e nisi studimin në vitin 1991. 27 studiues ndoqën zhvillimin e rreth 1300 fëmijëve kryq e tërthor Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilët vinin nga familje me prejardhje etnike dhe ekonomike të ndryshme. Ai u përqendrua në disa aspekte të kujdesit ditor si: cilësinë e tij, kohën e kaluar në qendrën e kujdesit ditor,

kohën e kaluar në grup, dhe sa herë nëna raportonte ndërrimin e çerdhes apo kopshtit.

Sipas këtij studimi, lidhja midis kohës së kaluar në kujdes ditor (i çfarëdolloj forme qoftë ai) dhe problemeve në sjellje, ishte më e madhe, se sa lidhja midis temperamentit të foshnjës dhe problemeve në sjellje, apo depresionit mëmësor dhe problemeve në sjellje. Kjo lidhje midis kohës së kaluar në kujdes ditor dhe problemeve në sjellje, ishte gjithashtu më e madhe tek fëmijët nëpër qendra, se sa tek ata me dado, etj.

Lidhja midis kohës së kaluar në kujdesin ditor dhe problemeve në sjellje, shfaqej në të gjitha llojet e prejardhjeve familjare, dhe në të gjitha llojet dhe cilësitë e kujdesit ditor. Autorët shtonin se, koha e kaluar në kujdes ditor gjatë foshnjërisë nuk dukej të kishte një peshë edhe aq të madhe mbi sjelljen e fëmijës, se sa koha e kaluar në të pas foshnjërisë. Studiuesit, gjithashtu, gjetën të dhëna që tregojnë se: fëmijët, të cilët ishin në një qendër kujdesi ditor me cilësi të mirë, në të cilin përkujdesësit u ofronin stimulim intelektual dhe ishin më të ngrohtë, më pozitivë dhe më të ndjeshëm ndaj sjelljes së fëmijës, kishin më pak grindje dhe probleme të raportuara mes fëmijës dhe përkujdesësit, apo edukatores se sa fëmijët, të cilët ishin vendosur në një qendër me cilësi të ulët. **Studiuesit, gjithashtu, zbuluan fakte që tregonin se kujdesi ditor me cilësi të lartë, nuk e eliminon lidhjen midis kohës së kaluar në kujdes ditor dhe problemeve në sjellje.**

Një nga zbulimet më rëndësishme të këtij studimi është se: parashikuesi më i mirë që tregon se sa mirë sillet një fëmijë, është një karakteristikë e nënës që studiuesit e

përshkruan si **ndjeshmëri**, çka do të thotë, sa i përshtatet nëna kërkesave dhe nevojave të fëmijës. Sjelljet e një nëne të ndjeshme janë të përqendruara tek fëmija; nëna e ndjeshme është e vetëdijshme për nevojat, gjendjen shpirtërore, interesat dhe aftësitë e fëmijës. Ajo e lejon këtë vetëdije të udhëheqë marrëdhëniet e saj me fëmijën. Fëmijët e nënave më të ndjeshme janë më aftë në shoqëri, kanë më pak të ngjarë të përfshihen në sjellje shkatërruese, dhe ka më pak të ngjarë të bien në konflikt me përkujdesësit dhe mësuesit e tyre. Ngjashëm, fëmijët, prindërit e të cilëve kishin më shumë të ardhura dhe ishin më të shkolluar, ishin gjithashtu më të aftë në shoqëri, dhe kishin më pak të ngjarë të kishin probleme në sjellje. Zbulimet e raportuara më parë nga Studimi i Kujdesit të Hershëm Ditor dhe Zhvillimit të Fëmijës tregojnë se: sa më shumë kohë e kaluar në kujdes ditor, aq më shumë probleme në sjellje tek 2- vjeçarët; një sjellje mëmësore jo të ndjeshme dhe një marrëdhënie nënë – fëmijë më pak harmonike, kur fëmijët ishin në moshën 6-36 muajsh. Po ashtu, edhe përqindje të larta të atashimit të pasigurt me nënën, nëse ajo ishte relativisht e pandjeshme.

Zhvillimi njohës

Sa dobi prodhojnë çerdhet e kopshtet në aspektin e zhvillimit njohës tek fëmijët? Përpjekja masive e njerëzve për t'i përgatitur fëmijët e moshës parashkollore për në shkollë është provuar nga studimet se është një iluzion. Duke patur parasysh 3 vitet e para të jetës së fëmijës ku truri është në zhvillim, ka lindur ideja se qendrat e kujdesit ditor janë në gjendje të japin stimulimin mendor për të cilin

kanë nevojë fëmijët gjatë kësaj faze formuese. **Por, ajo çka tregojnë studimet është se: “cilësia e përkujdesjes për fëmijët” – sa flasin dhe komunikojnë edukatorët me ata që kanë në ngarkim në mënyrë individuale, është ajo që lidhet me zhvillimin njohës të fëmijëve.** E meqë shumica e qendrave janë të cilësisë së dobët, sa i përket këtij aspekti, ato përbëjnë rrezik intelektual për foshnjat dhe parashkol-lorët. Në vitin 1991 një studim i Universitetit të Misurit zbuloi se mungesa e çerdhes dhe e kopshtit ishte parashikuesi më i mirë për arritjen e lartë në shkollë. Ka të ngjarë që problemet njohëse të pasqyruara në këto studime të vijnë si pasojë e mungesës së marrëdhënies nënë-fëmijë. Studimet tregojnë se arritjet e fëmijëve në shkollë mund të mbeten mjaft mbrapa nëse nënat punojnë me kohë të plotë.

Shumica e studimeve zbulojnë se kujdesi ditor i cilësisë së lartë, dhe ai tipik, nuk i vonojnë fëmijët në lidhje me moshën në të cilën shvillohen këto shprehje, apo aftësinë me të cilën ato shfaqen. Në të vërtetë, zhvillimi njohës i disa fëmijëve të cilët janë pjesë e kujdesit ditor përshpejtohet, por kujdesi ditor nuk prodhon gjithmonë dobi në aspektin njohës tek fëmija dhe, madje, edhe kur i realizon këto, efekti i tyre është i përkohshëm. Nga studimet është arritur në përfundimin se: sapo fëmijët e rritur në shtëpi hyjnë në shkollë, menjëherë i arrijnë bashkëmoshatarët e tyre që kanë qënë në kopsht. Për më tepër, shumica e studimeve sugjerojnë se, përfitimet njohëse të kujdesit ditor nuk janë të përhershme. Me mbarimin e klasës së parë, fëmijët të cilët nuk kanë ndjekur kujdes ditor, janë po aq të aftë sa edhe moshatarët e tyre të kopshteve. Ky nuk është një fakt për t'u habitur.

Zhvillimi social

Fëmijët të cilët ndjekin kujdes ditor jetojnë në një botë sociale më komplekse dhe më të ndryshueshme se sa ata që qëndrojnë në shtëpi. Ky fakt i ka shtyrë studiuesit të dyshojnë se fëmijët e kujdesit ditor do të shfaqnin aftësi sociale më të mira se sa moshatarët e tyre të rritur në shtëpi. Dhe, pjesërisht, ky dyshim qëndron. Fëmijët e lënë në kujdes ditor, vetëm sa shfaqen haptazi më të zgjuar në mënyrën si të bashkëveprojnë me njerëzit dhe çfarë të presin prej tyre, dhe kjo duket në sofistikimin e sjelljes së tyre sociale dhe lehtësinë relative me të cilën ata u afrohen njerëzve. Por, krahasuar me fëmijët e rritur në shtëpi, ata kanë më shumë të ngjarë të shfaqin sjellje të cilat shkojnë në ekstremin antisocial.

Fëmijët e regjistruar në kujdes ditor të cilësisë së ulët, shfaqin lojë më pak komplekse dhe nuk shkojnë mirë me moshatarët e tyre. Ata, gjithashtu, kanë shprehuri të dobëta pune dhe, janë më të vështirë për t'u disiplinuar nga të dy prindërit, po ashtu edhe nga mësuesit. Madje, edhe kur kushtet e kujdesit ditor janë më të mira, shfaqet një tatëpjetë në sjelljen e tyre. Fëmijët të cilët kanë qënë në kujdes ditor përshkruhen shpesh si konkurrues dhe agresivë me moshatarët e tyre, në krahasim me ata që janë rritur në shtëpi.

Një tjetër studim zbuloi se fëmijët e regjistruar në kujdes ditor qysh në moshë të hershme, ka më shumë të ngjarë të shtynë, godasin, shkelmojnë, kërcënojnë, mallkojnë dhe të zihen me fëmijët e tjerë. Këta fëmi-

jë janë më të prirur për të qenë më të pabindur, më kërkues, më urdhërues, më të djallëzuar, më të egër, më irritues, më rrebelë, më të pasjellshëm dhe më pak të pajtueshëm në përgjigje të kërkesave dhe urdhërave të dhëna nga përkujdesësit e tyre. Madje, edhe fëmijët me prejardhje nga klasa e mesme, që ndjekin një kujdes ditor me cilësi të lartë, shfaqin sjellje të këtij lloji, ndonëse kjo është më ekstreme tek fëmijët që vijnë nga familje me të ardhura ekonomike të ulëta.

Stresi toksik shkatërron zhvillimin e shëndetshëm të fëmijës

Të mësuarit e përballjes me stresin është një pjesë shumë e rëndësishme e zhvillimit të shëndetshëm të fëmijës. Kur përjetojmë stres aktivizohet sistemi i përgjigjjes ndaj stresit. Trupi dhe truri janë në vigjilencë. Në këtë rast ndodh lëshimi i hormonit të adrenalines, të rrahurat e zemrës shtohen dhe ngrihet niveli i hormoneve të stresit. Kur fëmija përjeton stres, nëse, pas një periudhe të shkurtër kohe, ai qetësohet apo mbështetet nga një i rritur, përgjigjja ndaj stresit shpejt i kthehet normalitetit . Në situata të rënda si psh, dhuna e vazhdueshme apo neglizhimi i vazhdueshëm ku nuk ka përkujdesje të të rriturve që të veprojnë si një qetësues kundër stresit, përgjigjja kundër stresit qëndron e aktivizuar. **Edhe atëherë kur nuk ka ndonjë kërcënim të dukshëm fizik, mungesa e pranisë së nënës mund të aktivizojë sistemin e përgjigjjes ndaj stresit. Aktivizimi i vazhdueshëm i përgjigjjes ndaj stresit i mbingarkon sistemet në zhvillim të fëmijës me rrjedhoja serioze afatgjata.** Ky njihet si stressi toksik. Me kalimin e kohës, kjo le pas një sistem përgjigje ndaj stres-

it i cili është vazhdimisht i “ndezur,” apo i aktivizuar në shkallën maksimale. **Në zonat e trurit që janë përgjegjëse për të mësuarit dhe për arsyetimin, lidhjet nervore që përbëjnë arkitekturën e trurit dobësohen dhe pakësohen në numër.** Shkenca tregon se aktivizimi i tejzgjatur i hormonit të stresit gjatë periudhës së fëmijërisë mund të pakësojë lidhjet nervore në këto zona të rëndësishme të trurit, pikërisht në kohën kur duhej të kishte lidhje të shumta dhe të reja. Stresi toksik mund të shmanget nëse ne sigurojmë që ambienti në të cilin rriten dhe zhvillohen fëmijët është edukativ, i qëndrueshëm (duke mos e ndërruar shpesh atë) dhe që mundëson angazhimin e fëmijës.

Rreziqet shëndetësore

Kujdesi në grup përbën rrezik për shëndetin e fëmijëve. Statistikat janë me të vërtetë tronditëse. Sipas një studimi të botuar nga Akademia Amerikane e Mjekëve të Familjes, fëmijët nëpër çerdhe e kopshte janë të prirur të sëmuren 18 herë më shumë se sa fëmijët e rritur në shtëpi. “Fëmijët nëpër qendra janë përgjegjës për shpërthimin e shumë sëmundjeve”, raporton një artikull i Mjekut Amerikan të Familjes. Duket se përqindja e lartë e transmetimit të sëmundjeve në qendra nuk ka të bëjë me cilësinë e qendrës, por është thjesht pasojë e grumbullimit të një numri të madh foshnjesh dhe parashkol-lorësh bashkë në një vend. Në çerdhe dhe kopshte, fëmijët i zë më shpesh gripi, puçrat, të ftohurit, kolla, gastroenteriti, infeksionet e veshit, infeksionet e bajameve, hepatiti ngjitës dhe meningiti i shtyllës kurrizore, se sa fëmijët të cilët nuk ndjekin kujdes ditor nëpër qendra. Kështu, prindërit, të cilët zgjedhin një kujdes ditor të përqendruar në shtëpi, bëjnë një zgjidhje të arsyeshme për të mirën e fëmijëve të tyre.

Pasojat afatgjata të kujdesit ditor

Prishja e marrëdhënies nënë-fëmijë, e lidhur me kohën e zgjatur nëpër çerdhe e kopshte, ka pasoja afatgjata. Atashimi i dobët në fëmijëri lidhet me nivele të larta të vetmisë, depresionit, ankthit, vetëvlerësimit të ulët, dhe paaftësisë për t'u përballur me vështirësitë e jetës së të rriturit. Në librin e tij “Të bëhesh i atashuar” Robert Karen thotë se: “Një stil i caktuar i mëmësisë që është i ngrohtë, i ndjeshëm, që i përgjigjet nevojave të fëmijës, dhe tek ai cili fëmija mund të mbështet, nxit mirëqenien emocionale. Marrëdhënia e çrregullt nënë-fëmijë mund të rezonojë në gjithë jetën e fëmijës në formën e vetëvlerësimit të ulët, marrëdhënie të dëmtuara, paaftësi për të kërkuar ndihmë, ose kërkimi i saj në mënyra të dëmshme, dhe zhvillim i shfytëruar i karakterit. Sipas Robert Karen psikologët kanë zbuluar se “atashimi i pasigurt i cili shfaqet në moshën 12 muajshe, është parashikues i sjelljes jo vetëm në moshën 3, 5, 7, apo 14 vjeçare, ... por gjithashtu në moshën 20, 30 dhe 60 atëherë kur njerëzit bëjnë zgjedhje romantike, martohen dhe përballen më pas me vetminë e pleqërisë.”

Disa studime të tjera afatgjata, që i kanë ndjekur fëmijët qysh nga lindja e në vazhdim përgjatë gjithë jetës, kanë treguar se në dekadën e 2-të të jetës eksperiencat e hershme të fëmijës ndikojnë dështimin në shkollë, shtatzaninë në adoleshencë dhe kriminalitetin. Në dekadën e 3-të dhe të 4-të të jetës shfaqet rreziku i obezitetit, tensionit të lartë të gjakut dhe depresionit. Në dekadën e 5-të dhe të 6-të shfaqen sëmundjet e zemrës, diabeti dhe sëmundje të tjera kronike. Ndërsa në moshën e thyer plakje e parakohshme dhe humbje e memories.

Mite dhe fakte rreth kujdesit ditor të fëmijës

MIT: Kujdesi ditor është i mirë sepse fëmijët marrin pjesë në aktivitete stimuluese dhe edukative dhe sepse ata mësojnë shprehitë sociale duke ndërvepruar me njëri-tjetrin.

FAKT: Kujdesi ditor ofron stimulimin dhe mundësinë e edukimit të një dite në burg, dhe përhap më shumë infeksion dhe sëmundje sesa burgu i qytetit. Fëmijët nuk i mësojnë shprehitë sociale nëpërmjet ndërveprimit me fëmijët e tjerë, po aq sa ç'mësohet pianoja nga fëmijët që s'marrin vesh nga muzika. Fëmijët i mësojnë shprehitë sociale duke vëzhguar dhe vlerësuar sjelljen e të rriturve.

MIT: Raportet e psikologëve që thonë se kujdesi ditor ËSHTË I MIRË dhe ... nuk e ndikon zhvillimin e fëmijës janë shpallur me më madhe në media dhe me shkrim të theksuar.

FAKT: Ndërsa raportet që tregojnë se kujdesi ditor NUK ËSHTË I MIRË dhe se fëmijët vuajnë, janë njohur vetëm në revista të vogla trime. Faktet (të fshehura nga sytë e publikut) thonë se kujdesi ditor, veçanërisht ai i plotë, është shkatërrues për rritjen emocionale dhe intelektuale të fëmijës dhe për zhvillimin e ndërgjegjjes.

Citate nga psikologë të njohur amerikanë

Dr. Benjamin Spock pediatri i famshëm dhe eksperti i edukimit të fëmijës (1903-1998) ka thënë: “Qendrat e kujdesit ditor nuk janë të mira për fëmijën. Askund fëmija nuk e gjen vëmendjen dhe dashurinë për të cilën ka nevojë. Meqenëse fëmijët kanë nevojë për dashuri dhe vëmendje të plotë, në vitet e para të jetës së tyre, për prindërit është e pakuptimtë të paguajnë të tjerët të bëjnë një punë të dobët për rritjen e fëmijëve të tyre.”

Jay Belsky, profesor i psikologjisë në Bribeck College, Londër ka thënë: “**Kujdesi ditor është një novelë evolucioniste**, e cila nuk ka asgjë të përbashkët me kujdesin ndaj fëmijës nëpër gjithë historinë e njerëzimit, apo në shoqëritë tradicionale moderne. **Të kuptuarit e pasojave negative që ka kujdesi ditor mbi fëmijët është fshehur nga politika duke përfshirë të drejtat e grave, etjen e madhe të qeverive për rritje ekonomike, nga faji mëmësor dhe nga portretizimi që i bën media zbulimeve që janë bërë në këtë fushë.** Disa kërkues të cilët i kanë bërë të zëshme shqetësimet e tyre, janë sulmuar ashpër. Gjithsesi, pyetja e sikletshme mbetet përsëri: Çfarë është më e mirë për fëmijët gjatë ditëve të javës: nëna biologjike, apo një punëtore e paguar në një institucion?”

Elaine Heffner, një psikiatre për fëmijë nga Nju Jorku, është shprehur në librin e saj “**TË JESH NËNË**”, **Eksperiencia Emocionale e Mëmësisë pas Frojdit dhe Fëmizmit**: “Nëse gjithnjë e më shumë gra do t’ua dorëzojnë fëmijët e tyre, në mosha gjithnjë e më të njoma, ca grupeve

të kujdesit ditor të sponsorizuara nga qeveria, kjo eksperiencë e re e fëmijërisë, në mënyrë të pashmangshme do ta riformatojë personalitetin, ashtu siç ka vepruar më parë edukimi i fëmijëve me qendër fëmijën. Është e qartë se, kujdesi ditor në grup mund të realizohet nëpërmjet një varësie më të madhe, në përshtatjen dhe nënshtrimin ndaj grupit, çka nuk le vend për plotësimin e nevojave të individit. Kjo, gjithashtu, do të thotë se, përvoja e fëmijërisë së hershme do të formohet nga një pikëpamje e vetme, e varur gjithnjë e më shumë nga kontrolli burokratik i jashtëm. Kjo do të fillojë edhe më herët presionet e shoqërisë së industrializuar, e cila në tërësi militon kundrejt barazisë dhe humbjes së identitetit personal. Në një shoqëri të tillë familja është fortesa e fundit e individualitetit, ndërsa nëna avokatja e fundit për personalitetin e fëmijës së saj.”

ÇFARË DUHET TË MËSOJNË FËMIJËT E MOSHËS PARASHKOLLORE?

Para se të mësojnë ABC – në dhe aritmetikën, fëmijët e moshës parashkollore duhet të mësojnë Fjalën DASHURI në kuptimin më të plotë dhe më gjithëpërfshirës të saj. Ata duhet të mësojnë se janë qenie të rëndësishme për prindërit e tyre, sidomos për nënën. Ata duhet të kuptojnë se janë unikë, të ndihen dashur dhe të vlerësuar, të ndihen të pavarur, të aftë, të mësojnë shprehi të mira komunikimi, të mësojnë t’u binden prindërve të tyre dhe më të moshuarve. Gjithashtu ata duhet të zhvillojnë dy aftësi shumë

të rëndësishme për moshën e tyre, siç janë vëmendja dhe vetëkontrolli. Tek ata duhet të nxiten aftësitë krijuese dhe mendimi kritik. Mbi të gjitha duhet të mësojnë dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Këtë mund ta mësojnë vetëm nga nëna duke qenë vazhdimisht nën përkujdesjen e fjalëve dhe këshillave të saj. Para se të shtjellojmë se çfarë duhet të mësojnë fëmijët e moshës parashkollore duhet të shpjegojmë dhe kuptojmë disa nevoja që lidhen me zhvillimin e tyre.

Nevojat zhvillimore të fëmijës

Eksperti i zhvillimit të fëmijës **Dr. Stanley Greenspan** i përmbledh nevojat zhvillimore të fëmijës në 6 fusha kryesore:

1. Pamjet, tingujt, prekjet, dhe të gjitha ndjesitë e tjera që i përshtaten sistemit nervor unik të çdo fëmije, me qëllim që të nxitim vëmendjen, vetëdijen, të mësuarit, gjuhën, dhe vetëkontrollin.
2. Një marrëdhënie dashurie intime, e vazhdueshme (e cila zgjat me vite, e jo me muaj) me një apo disa përkujdesës, me qëllim që fëmija të zhvillojë përkujdesjen për të tjerët, empatinë dhe besimin.
3. Marrëdhënie me të rriturit të cilat përbëhen prej sekuecave të gjata të ndërsjellta të buzëqeshjeve, tonit të zërit, gjeسته, tingujve, të zgjaturit për të prekur, etj. Këto “dialogje emocionale” nxitin tek fëmija zhvillimin e qëllimit, ndjenjës për veten dhe komunikimeve logjike.

4. Ndërveprimet e gjata me anë të gjesteve dhe, si rrjedhim, gjestet dhe fjalët për të zgjidhur problemet, gjë e cila nxit tipet e hershme të të menduarit dhe aftësive sociale.
5. Loja e pretenduar (apo gjasme) dhe shkëmbimi i ideve spontane mes përkujdesësit dhe fëmijës, me qëllim që të nxitin zhvillimin e gjuhës dhe kreativitetin.
6. Përdorim logjik i ideve kur përkujdesësi nxit opinionin e fëmijës dhe debatin me të, me qëllim që të zhvillojë të menduarit logjik, planifikim dhe gadishmërinë për leximin dhe matematikën.
7. Greenspan arrin në përfundimin se plotësimi i këtyre nevojave thelbësore varet nga një marrëdhënie emocionale, e cila është tërësisht e pamundur të arrihet në një çerdhe apo kopësht, por është “thuaje automatike” në familje. Kjo për shkak të ndërrimit të shpeshtë të edukatoreve dhe numrit të madh të fëmijëve që i bien një punonjëse, gjë që nuk bën të mundur atë lloj atashimi me një përkujdesës, për të cilin ekspertët thonë se është vitale për zhvillimin e fëmijës deri në tre vjeç.

Pavarësia

Çfarë lloj pavarësie duhet të mësojnë fëmijët 0-7 vjeç?

Omeri r.a. ka thënë për fëmijën: 7 vitet e para lëre të lirë, 7 vitet e dyta këshilloje, 7 vitet e tjera bëje shok. Me tre shprehje koncize është përmbledhur gjithë korniza e edukimit të fëmijës, ku themeli i tij duhet të jetë liria dhe pavarësia.

Si mund ta mësojë pavarësinë një fëmijë kur në zhvillimin e tij, çdo ditë aktivitetet që kryen janë të drejtuara nga të rriturit dhe ai nuk është në gjendje të marrë vendime si mund ta kalojë kohën?

Qëllimi i nxitjes së zhvillimit të fëmijës drejt pavarësisë përfshin më tepër se sa të mësuarit e fëmijës të hajë vetë, apo të vishet vetë. Qëllimi është të ushqejmë zhvillimin e autonomisë, kapacitetin për një të menduar të pavarur, për zgjidhjen e problemeve, për zhvillimin e cilësive unike të një personaliteti individual. Problemi është se, metodat autoritare, të imponuara nga lart, nuk krijojnë liri; përkundrazi, ato e përforcojnë varësinë. Pavarësi nuk do të thotë thjesht aftësi për të bërë diçka, por edhe aftësi për të vendosur për atë që do të bësh. Nuk është vetëm aftësia për t'u kujdesur për veten, por, është gjithashtu edhe aftësia për të marrë përgjegjësi për veten. Autonomia dhe pavarësia nuk burojnë nga të thënit se çfarë të bësh, dhe kur ta bësh. **Vetëm duke iu respektuar nevojat dhe duke u bërë pjesëmarrës në procesin e vendimmarrjes, fëmija zhvillon kapacitetin për autonomi.**

Çfarë nevojash i merren parasysh fëmijës kur ai largohet çdo ditë nga familja e tij...?

Shpërblimi i të qenit i pavarur është aftësia për të vendosur vetë se ku do të shkosh. Edukimi i fëmijëve është një proces përcaktimi se ku ndodhet fëmija në gadishmërinë e tij për të ndërmarrë hapin tjetër përpara. Personi më i mirë, që ndodhet në pozicionin më të favorshëm për ta ditur këtë, është nëna, sepse nëna është ajo që ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me fëmijën që nga lindja.

Zhvillimi i shprehive të mira sociale dhe aftësive të komunikimit

Fëmijët sillen në bazë të impulseve dhe sipas dëshirave të tyre, pa shumë dijeni për pasojat e sjelljes së tyre mbi dikë tjetër. Nëna ka profesionin e mësimit të fëmijës së saj për të menduar mënyrat me të cilat sjellja e tij **ndikon** të tjerët, apo veten e tij dhe të ndihmës ndaj tij për të kontrolluar impluset ndërsa ai është duke mësuar. **Në zhvillimin e sjelljeve sociale detyra kryesore e nënës është rritja nga një pozicion ku fëmija kërkon vëmendje totale për të plotësuar nevojat dhe ndjenjat, drejt pikës ku ai do të jetë në gjendje të marrë parasysh nevojat dhe ndjenjat e të tjerëve.** Si mund t'i marrë ai parasysh më vonë nevojat dhe ndjenjat e të tjerëve kur ai nuk ka mësuar se nevojat e tij merren parasysh dhe respektohen?

Për këtë arsye, një detyrë themelore e edukimit të fëmijës parashkollor është ta mësosh si të shprehet në mënyra më të pranueshme. Meqë nëna është mësuesja e parë, ajo

është e para që përballët me dikë që nuk ka mësuar ende si të marrë parasysh kërkesat dhe nevojat e të tjerëve. **Qëllimi në marrëdhënien nënë - fëmijë është hedhja e themeleve të një klime të arsyetimit, në të cilën, ajo dhe fëmija e dëgjojnë njëri-tjetrin.** Fëmija ka nevojë për shumë përsëritje për të mësuar se si funksionojnë marrëdhëniet. Nëna duhet të jetë aq elastike sa për të vazhduar të zgjidhë çdo konflikt të veçantë që mund të ketë me fëmijën. Asnjë nuk mund t'ia kalojë krijueshmërisë së zgjidhjeve të një nëne, kur ajo është emocionalisht e lirë për t'i gjetur vetë këto zgjidhje. Për t'i mësuar fëmijës objektivin më të madh për respektin ndaj të tjerëve, nëna mund të tolerojë pak frustrim të dëshirave të saj, ajo mund të vonojë atë që dëshiron, ajo mund të jetë aq e përkulshme sa të bëjë marrëveshje. E kjo është pikërisht ajo që duhet të mësojë edhe fëmija: që është e mundur t'i mbijetojë frustrimit, që është e mundur të presë për atë që dëshiron, që është e mundur të bëjë marrëveshje pa kapitulluar.

Një sfidë për nënën është të bëjë dallimin midis sjelljes dhe ndjenjave të fëmijës, për të mbështetur kapacitetin për siguri në vetvete tek fëmija, teksa i mëson atij mënyra më të pranueshme për ta shprehur atë.

E si mund të mësohen shprehitë e mira sociale dhe ato të komunikimit me të tjerët në një ambient ku fëmijës i kushtohet vëmendje minimale e ku nuk bëhet fjalë për dialog dhe marrëveshje ku ai të ndjejë se respektohet dhe dëgjohej? Vendin e tij në komunikim si individ e ka zënë grupi. Ai nuk ekziston.

Vetëvlerësimi

Vetëvlerësimi është shkalla në të cilën fëmijët ndihen të pranuar dhe të vlerësuar nga të rriturit dhe moshatarët të cilët janë të rëndësishëm për ta. Zhvillimi i tij është shumë kompleks. Ai zhvillohet së brendshmi si dhe i jepet formë nga njerëzit e tjerë që e rrethojnë fëmijën. Zhvillimi i vetvetes ndodh në faza dhe formësohet nga eksperiencia. Faza e parë dhe më e rëndësishme në zhvillimin e vetëvlerësimit është **zhvillimi i ndjenjës së besimit** tek të rriturit që kujdesen për ta. Fëmijët duhet të mësojnë së pari të kenë besim tek të tjerët, në mënyrë që më vonë të mbështeten në vetvete. Të rriturit, të cilët i rrethojnë me përkëdhelje, ngrohtësi dhe u përgjigjen nevojave të tyre, hedhin themelet e një vetëvlerësimi të mirë, sepse ata e bëjnë fëmijën që të ndihet i dashur nga të tjerët, i dëshiruar dhe i vlerësuar. Foshnjat të cilat nuk rrethohen nga rehati i domosdoshëm, të cilat nuk mbahen, nuk komunikohet me to, nuk përkunden dhe nuk u shfaqet dashuria, marrin një mësim tjetër për vlerën e tyre. Ato mësojnë se të qarat e tyre të dëshpëruara nuk sjellin qetësi. Ato mësojnë se janë të braktisur dhe nuk janë të rëndësishëm. Këto janë mësimet e para të një vetëvlerësimi të varfër. Çfarë vetëvlerësimi mund të mësojnë foshnjat nëpër çerdhe dhe pak më të rriturit në kopshte? Aq më keq akoma kur mbi foshnjat, apo fëmijët parashkollorë që qajnë ushtrohet dhunë emocionale dhe fizike, e cila është ende e pranishme këtu në Shqipëri.

Kur fëmijët fillojnë të ecin kanë nevojë për **një ambient të sigurt dhe që i mbështet** në mënyrë që të eksplorojnë.

Pa këtë dëshirë natyrale për të prekur, shijuar, dhe ndier sendet që i rrethojnë, ata nuk mund të bëhen gati për në shkollë. Fëmijët kanë nevojë për një ambient ku nuk ka pse të dëgjojnë fjalën “MOS” gjithë kohën. Nëse fëmijët nuk e ndjejnë se mund të eksplorojnë të lirë, ndihen të turpëruar dhe i venë në dyshim aftësitë e tyre. Rreth moshës 18 muajsh fëmijët fillojnë të bëhen të pavarur. Prindërit që e pranojnë këtë nevojë për pavarësi dhe nuk fillojnë ta pengojnë fëmijën në çdo gjë që bën, do të marrin si shpërblim një fëmijë i cili është i interesuar dhe i mëson gjërat në mënyrë të pavarur. Këta fëmijë do të mësojnë të mbështeten tek forcat e tyre. Të ndihmohet fëmijët të ndihen të sigurt në vetvete dhe të marrin vendime vetë çdo ditë, do t'i shërbejë si një bazë e shëndoshë për gjithë jetën. **Vetëvlerësimi i ulët (të ndjerit i padashur, dhe i papranuar) shpesh shkakton paaftësi në të mësuar, probleme me sjelljen dhe depresion më vonë në moshën e të rriturit.**

Zhvillimi i vëmendjes

Vëmendja është aftësia për t'u përqendruar, ndjekur, dhe mbajtur përqendrimin përgjatë një periudhe kohe është një process i brendshëm që duhet të zhvillohet tek fëmijët e moshës parashkollore. Ambienti i grupit tek parashkollorët, të cilët rrethohen përditë me orë të tëra prej bashkëmoshatarëve pengon zhvillimin e vëmendjes. Qendrat, si çerdhet e kopshtet nuk mund të ofrojnë marrëdhënien fytyrë më fytyrë me vetëm një të rritur për të cilën kanë nevojë fëmijët për të zhvilluar aftësinë e përqen-

drimit mbi një detyrë të caktuar, por përkundrazi, në to ka shumë zhurmë dhe aktivitete të shumta në grup, të cilat nuk bëjnë të mundur zhvillimin e kohës së mjaftueshme për vëmendjen tek parashkollorët. Fëmijë të tillë, shpesh, nuk mund të ulen e të qëndrojnë të qetë apo të përqendrohen në diçka për një kohë të gjatë, shpërqendrohen lehtë, janë hiperaktivë dhe në përgjithësi shpërthyes.

Mësimi i bindjes ndaj prindërve

Bindja ndaj prindërve është e lidhur ngushtë me dashurinë dhe nevojën për ta. Nevoja që ka fëmija për nënën e tij është shembulli më i ngjashëm i nevojës që ai do të ketë gjatë gjithë jetës për t'u mbështetur tek dikush tjetër, deri në një farë mase, për mirëqenien e tij psikologjike dhe fizike. **Është piërisht kjo nevojë, që e bind atë të fillojë të respektojë kërkesat e nënës së tij.** Ajo i mëson fëmijës mënyrat me të cilat duhet të merren parasysh dëshirat e saj dhe do ta ketë të vështirë ta arrijë këtë, nëse beson se ajo nuk meriton asnjë lloj respekti, apo fëmija nuk meriton fare respekt. **Nëse u duhet dy njerëzve të zgjidhin ndryshimet e tyre, atyre u duhet në fillim të zbulojnë se cilat janë këto ndryshime. Secilit prej tyre i duhet të jetë i aftë të dëgjojë se çfarë dëshiron tjetri. Zgjidhja e paqte e konflikteve mes nënës dhe fëmijës kërkon lëshime dhe kompromis.** Nëse kjo duhet të bëhet për të zgjidhur një konflikt mes dy njerëzve, atëherë dikush duhet të bëhet gati për të dëgjuar tjetrin i pari. Ky model duhet të hedhë themelet në marrëdhënien nënë - fëmijë. **Nëna, që është më e pjekur, ka më tepër kontroll mbi veten dhe durim më të madh mbi frustrimin, dhe që është në pozicion më**

të fortë për shkak të nevojës që ka fëmija për aprovimin e saj, është ajo që duhet të dëgjojë e para nevojat dhe dëshirat e fëmijës. Fëmija, pasi mëson se nëna e *dëgjon* atë, se dëshirat e tij *do të* merren parasysh, atëherë është në gjendje ta dëgjojë nënën. Zemërimi që ndjen fëmija kur detyrohet të bëjë diçka me forcë, nuk është aspak ndihmues në respektimin e dikujt tjetër. Kjo është njëlloj e vërtetë për nënën dhe fëmijën.

Mësimi i vetëkontrollit

Vetëkontrolli i sjelljes është monitorimi njohës dhe i kontrolluar të veprimeve, apo hapave që kërkohen për të arritur një qëllim, objektiv, apo për të sjellë një përgjigje të dëshiruar nga ambienti. Kur një fëmijë parashkollor i kujtohet një rregull, apo nuk kthen përgjigje, nuk godet, apo nuk tregohet impulsiv, ai po shfaq aftësinë për të rregulluar emocionet dhe impulsset e tij. Kërkimet dhe teoria kanë arritur në përfundimin se aftësitë kritike për sukses në shkollë gjenden tek vëmendja, përqendrimi dhe aftësia për të përcaktuar dhe përdorur burimet që kemi në dispozicion. **Mënyra me të cilën fëmijët e mësojnë vetëkontrollin, ndryshe nga shprehitë motorike është një proces psikologjik i përvetësimit të kërkesave morale nga një sistem kompleks i kultivimit, modelimit, të kuptuarit, aprovimit dhe mosaprovimit. Dhe, duket se mënyra me të cilën zhvillohet ky sistem ndodh nëpërmjet përkujdesjes së vazhdueshme, të përkushtuar dhe çështë me e rëndësishmja të individualizuar (vetëm nga një i rritur).** Kjo na ndihmon të kuptojmë se pse fëmijët që kalojnë orë të tëra në çerdhe e kopshte piren për të qenë më agresivë,

dhe të pabindur, sepse ndjeshmëritë e tyre morale janë shkatëruar prej mungesës së atashimit vetëm me një të rritur, parakusht ky për përvetësimin e kodit moral.

Nga fillimi i klasës së parë fëmijët priten të kenë një masë vetëkontrolli. Ka një ndryshim të madh mes të ngulurit për disa orë rresht në karrigen e vogël me të luajturit jashtë, e cila është njëkohësisht edhe zgjedhja e vetë fëmijës. Cili është ambienti i përshtatshëm sipas moshës së fëmijës i cili nxit të mësuarit brenda apo jashtë katër mureve? Është pikërisht ai ambient jashtë katër mureve, një hapësirë e cila nxit kuriozitetin e fëmijës, në të cilin fëmija shpreh kreativitetin e tij. Fëmijët kanë nevojë të madhe për ushtrime fizike: ecje, biçikletë, rrëshkitje, apo vallëzim. Duhet të nxitim lëvizjen tek fëmija, jo vetëm si një mënyrë për të menaxhuar stresin dhe emocionet, por edhe për të patur një shëndet të mirë dhe për të krijuar një mendje dhe trup të qetë.

Formimi i karakterit të fëmijës dhe cilët janë faktorët që e ndikojnë atë?

Sipas Prof. Dr. Muhamed El –Mehdi, themelues i Institutit Khalifah në Malajzi dhe i njëres prej faqeve të internetit më të vizituara islame në botë, faktori primar që përcakton karakterin e çdo njeriu është ambienti ku ai rritet. Ambienti përbëhet prej tre aspektesh që ndikojnë karakterin e individit:

1. Ambienti Fizik
2. Ambienti Social
3. Dialogu i Brendshëm (me vetveten)
Dialogu i brendshëm ngrihet mbi eksperiencat e akumuluarat të jetës, të cilat janë ruajtur në Përvojën Totale të të Mësuarit (PTM) dhe është një faktor kryesor në mënyrën se si ne i perceptojmë të gjitha gjërat. Përveç kësaj, ndikimi i faktorëve të ambientit ngjyrosset edhe me perceptimin unik që ka individi për ambientin.

Çfarë lloj karakteri zhvillojnë fëmijët në çerdhe e kopshite dhe çfarë përbën ai për shoqërinë tonë?

Në kohën tonë familja është bërë shënjestra e parë e atyre që kanë për qëllim ta minojnë atë, duke përbuzur rolin e prindërve duke bërë që ky rol të duket i dalë mode dhe i vjetëruar dhe duke bërë që prindërit të heqin dorë dalëngadalë nga përgjegjësitë e tyre mbi fëmijët. Askund nuk gjën si për çudi të flitet për rolin që kanë prindërit mbi fëmijët sidomos në media, fjala nënë nuk dëgjohet. Debatet në televizion bëhen të llojit bebsiter, kopësht apo gjyshe? Nëna është zhdukur nga skena. A duhet që ne muslimanët të biem pre e të tilla arsyetimeve?

Funksionet primare të familjes janë ato të rritjes dhe socializimit të fëmijës. Formimi i inteligjencës së fëmijëve, moralit, mirëkuptimit ndaj të tjerëve, dhe ndjenjës së

identitetit janë përgjegjësitë më thelbësore të prindërve. Prindërit i ndihmojnë fëmijët të rriten duke u bërë njerëz të pajisur me aftësinë për t'i dashur të tjerët dhe për të funksionuar në mënyrë të pavarur. **Familja është shkolla e parë e virtyteve shoqërore.** Por, nga përjetimi gjithnjë e në rritje i kujdesit ditor nëpër institucione, përvoja e familjes fshihet dhe zvogëlohet.

Prishja e lidhjeve familjare ndikon thellësisht personalitetin e fëmijëve dhe kjo mbetet e pakapur nga studimet të cilat fokusohen vetëm në arritjet shkollore dhe sjelljen e dukshme të fëmijës. Disa studiues kanë filluar të tërheqin vëmendjen e njerëzve mbi pasojat që ka ambienti i kopshtit mbi karakterin e fëmijës.

Këto dinamika të ndryshuara të rritjes së fëmijëve sjellin si pasojë orientimin thellësisht të ndryshëm të karakterit të fëmijëve. **Humbja e privacisë dhe spontanitetit, të cilat ofrohen natyrshëm në ambientin e shtëpisë kërcënojnë zhvillimin e identitetit individual.**

Muhamedreza Hojat, profesor i psikiatrisë në Jefferson Medical College në Filadelfia paralajmëron se fëmijët e rritur në institucione “mund të mos zhvillojnë konceptet e vërteta të mëshirës dhe kujdesit për të tjerët.” Si pasojë e praktikimit gjithnjë e në rritje të kujdesit institucional për fëmijët “shumë e shumë prej tyre nuk arrijnë të përftojnë të kuptuarit e hershëm të koncepteve si: dashuria mëmësore, kujdesi për të tjerët, plotësimi i nevojave të të tjerëve, mëshira, dinjiteti, respekti, etj. dhe, për këtë arsye dështojnë në përvetësimin e këtyre koncepteve.

Dr. Stanly Greenspan ofron një përcaktim të ngjashëm: “Njerëzit mund të bëhen gradualisht më egoistë dhe të përqendruar tek vetja dhe aspak të shqetësuar për të tjerët. Të menduarit mund të bëhet i polarizuar, o gjithçka o asgjë, më tepër se i stërholluar dhe refleksiv. Sjellja impulsive, pafuqishmëria dhe depresioni mund të rriten. Aftësia për ndërgjegjësim të vetvetes dhe aftësitë e zgjidhjes së problemit mund të bien, ashtu siç do të bierë dhe kapaciteti ynë për të jetuar së bashku.”

Në ambientin e familjes ofrohet siguri, mbrojtje dhe vetëbesim, ndërsa institucioni shkakton mungesë vetëbesimi dhe sigurie, dhe një ndjenjë të pazhvilluar për vetveten gjë që sjell mungesë vetëkontrolli tek fëmijët, agresivitet dhe egoizëm në sjelljet sociale. Profesor Jay Belsky ka arritur në përfundimin se foshnjat që e kalojnë 8 orarshin në institucion “mund t’i bëjë ato që t’i shmangin prindërit e tyre në një mënyrë, që mund të interpretohet si inat i fshehur, pra një një vetvete false. Nuk është e pazakontë, thotë profesor Belsky, që këta fëmijë të zhvillojnë një tip karakteri manipulativ.”

Një ambient kolektiv që shpërblen të qenit konfrom grupit më shumë se sa të menduarit kritik dhe zbulimin e pavarur, nxit aftësitë sociale të manipulimit, s’ka rëndësi, nëse janë këto mjete për të tërhequr vëmendjen, apo reagime të dhunshme kur nuk të shkon e jotja, apo sjellje sa për sy e faqe konform rregullave të ambientit dhe bindje për të fituar aprovim. **Grupi nuk nxit në vetvete tek fëmija zhvillimin e ndjenjës së rregullave të përvetësuar të cilat e kapërcejnë ambientin, të ndjenjës se ç’është e mirë e ç’është e keqe, pavarësisht nga dëshirat e çastit të fëmijës.**

Studimi i famshëm nga Bruno Bettelheim i fëmijëve të rritur në kibbutzin (kopshtin) izraelit e përçon këtë përfundim. Ai vuri re se fëmijët u bënë të orientuar drejt grupit më tepër se drejt individit. Prindërit filluan të shprehin një mungesë shqetësimi për fëmijët e tyre, meqenëse komuniteti mori përsipër përgjegjësitë e rritjes së fëmijëve. Bettelheim gjithashtu vuri re se për këta fëmijë ndërgjegjja nuk mori formën normale të përvetësimit të autoritetit prindëror, por më tepër një përvetësim të rregullave të komunitetit kolektiv. Në këtë kontekst, morali u bë një çështje pragmatike. **Ai arriti në përfundimin se kur dobësohet roli prindëror tek fëmija dhe grupet e bashkëmoshatarëve marrin përsipër rolet familjare, dashuria ndahet nga disiplina dhe ndërgjegjja e fëmijës bëhet “e drejtuar nga jashtë” drejt asaj çfarë është e nevojshme për të qënë në pajtim me ambientin rrethues. E drejta dhe e gabuara zëvendësohen me të qënit në modë apo jashtë mode. Ka dy mundësi për njerëzit, të cilëve u mungon një burim i brendshëm i vlerave: tërbimi i adoleshencës dhe nihilizmi, që e shprehin veten në ato që njerëzit i quajnë zënka të pakuptimta shkolle, të cilat mund t’i kenë rrënjët në ndërgjegjjen e pazhvilluar që vjen si pasojë e prishjes së marrëdhënies prind - fëmijë.**

Siç mund të kuptohet, feminizmi ia arriti qëllimin kur e nxori nënën me fëmijë nga shtëpia dhe bebet i la në dorë të edukatoreve të cilat i stërvisin vetëm për një qëllim: të bëhen individë të aftë vetëm ekonomikisht.

Kjo prirje, për të formuar të rritur që janë të prirur vetëm drejt suksesit material dhe që u mungon ndërgjegjja, u shqua 20 vjet më parë nga David Elkind në librin e tij “Fëmija i nxituar: Të rritesh shumë shpejt, e shumë herët”.

Elkind shkroi për një brez të rinjsh “që shfaqnin simptomat e të qenit të shfrytëzuar prej prindërve të tyre, duke humbur identitetin dhe të qenit unik pa asnjë shkak.” Sipas Elkind kjo sindromë reflektonte një prirje në rritje për ta parë fëmijërinë si një bazë stërvitje për të fituar shprehitë e nevojshme që arrijnë suksesin në botën e të rriturve, më shumë se sa një periudhë të ndarë të rritjes në pjekuri, virtut dhe karakter që duhet të paraprijë moshën e rritur.

Qëllimi i edukimit parashkollor ka qënë dhe është dizenuar për t’i stërvitur bebet për vendin e punës, duke mos i lënë aspak vend formimit të karakterit të mirë, duke minuar kështu vendin e familjes si shkolla e parë dhe e vetme e karakterit të fëmijës.

Zhvillimi i aftësive krijuese dhe të menduarit kritik

Krahasuar me ambientin e shtëpisë, ai i kopshtit ofron shumë pak vend për shprehjen individuale të fëmijës dhe zhvillimin e aftësive krijuese dhe kritike. Fëmijës nuk i jepet vendi për të cilin ai ka nevojë për t’u zhvilluar i veçuar nga grupi, gjë që rezulton në një mentalitet konformist dhe një ndjenjë difektoze të vetvetes.

Autori dhe kritiku social Walter Karp ka shkruar: “Për shkak të intimitetit të saj, familja është streha e parë e krijeshmërisë njerëzore.” Ambienti i mbrojtur i shtëpisë apo i lagjes rreth e rrotull saj me mbikqyrjen e prindërve lejon pavarësi më të madhe dhe më pak regjimentim në zhvillimin e fëmijës. Loja e fëmijës në shtëpi apo në lagje është

shumë më pak e organizuar nga të rriturit sesa ambienti i kopshtit ku “aktivitetet e planifikuara” janë normë.

Një projekt i Institutit Smithsonian në Amerikë, në vitin 1990 kishte për qëllim të zbulonte burimin e kreativitetit dhe aftësive drejtuese në fëmijërinë e hershme. Ky studim zbuloi se **ndikimi më i rëndësishëm në aftësitë krijuese dhe drejtuese të fëmijëve ishte “lidhja e ngushtë dhe e vazhdueshme prind – fëmijë.”** Në këtë studim u zbulua se të rriturit që ishin me karakter të fortë në fëmijërinë e tyre kishin kaluar kohë me bashkëmoshatarët e tyre, por gjithashtu kishin shumë mundësi për ta eksploruar botën të lirë në sajë të nxitjes prindërore. Asnjëra nga këto nuk është pjesë e çerdhes apo e kopshtit. Me qëllim që të kenë kontroll mbi fëmijët, edukatorët në kopësht përsërisin të njëjtat aktivitete çdo ditë. Si pasojë, është fëmija ai që duhet t’i nënshtrohet ambientit pa marrë asnjë përgjigje për karakterin e tij individual, talentet apo nevojat e tij. Duke qënë nën presionin social të grupit, fëmijët nuk kanë mundësi të zbulojnë potencialin e tyre krijues.

Marrëdhënia nënë –fëmijë ofron lehtësi të mëdha në zhvillimin e të menduarit kritik dhe aftësive krijuese të fëmijës. Gjatë dialogut të vazhdueshëm me fëmijën që nga lindja, nëna nxit të pyeturit gjë që është thelbësore në këtë aspekt. Dialogu i tyre spontan e lejon fëmijën të bëjë pyetje pa fund, së cilave nëna i përgjigjet pa u lodhur e pa u mërzhitur aspak.

Po ne si dëshirojmë të bëhen fëmijët tanë? A dëshirojmë që ata ta imitojnë këtë shoqëri dhe të jenë kokëulur duke u pajtuar me realitetin apo duam që ata ta shohin me sy kritik atë dhe të përpiqen ta ndryshojnë atë me të gjitha forcat?

Si mund t'i përgatitim fëmijët parashkollorë për në shkollë?

Përgatitja e fëmijëve parashkollorë për në shkollë shihet në masë si diçka që kërkon ndërhyrjen e specialistëve apo edukatoreve. Ky është provuar të jetë vetëm një iluzion i përhapur qëllimisht për të nënvleftësuar rolin e prindërve. Këtë përgatitje mund ta bëjnë të mundur fare mirë prindërit.

Dr. Caron Goode dhe Kevin Heath në librin e tyre, “Si mësojnë fëmijët” thonë se:

“Shtëpia është vetë një ambient të mësuar për fëmijën. Qysh nga lindja deri në moshën 5-6 vjeçare fëmijët mësojnë nëpërmjet kontaktit dhe eksperiencës së drejtpërdrejtë.

Studimet kanë treguar se: motivimi i fëmijëve (për të mësuar) fillon dhe mbaron me marrëdhënien prind-fëmijë, që nga vitet e hershme dhe në vazhdim përgjatë viteve të shkollës.

Parashikuesit më të saktë të suksesit akademik në shkollë janë përfshirja e prindërve në këto fusha:

1. Krijimi i një ambienti në shtëpi i cili stimulon të mësuarit
2. Shprehja e pritshmërive realiste ndaj fëmijës për të ardhmen e tij
3. Përfshirja e prindërve në edukimin e tyre.

Faktet janë të qarta: suksesi i fëmijëve, veçanërisht ai akademik, varet nga marrëdhënia juaj me fëmijën dhe ai fillon pikërisht në ambientin e shtëpisë. Këtu lind pyetja: Si është ky ambient që e stimulon të mësuarit? Kërkesit, veçanërisht në fushën e edukimit të hershëm të fëmijës, tregojnë se ambienti nxitës për shkollim ka disa elementë mjaft domethënës.

1. **Elementi i parë është pikërisht një i rritur i përgjegjshëm dhe që i përgjigjet nevojave të fëmijës. Fjala kyç këtu është kjo e dyta. Përgjigjja ndaj nevojave të fëmijës është kritike për zhvillimin e fëmijës.** Plotësimi i këtyre nevojave do të thotë që prindi duhet të jetë intuitiv, dhe që i shkon për shtat nevojave psikologjike të fëmijës. Po ashtu, ky plotësim i nevojave të fëmijës përfshin gjithë aspektet, si atë njohës, social, emocional dhe atë fizik.

2. Plotësim i nevojave të fëmijës përkufizohet si sasia dhe lloji i marrëdhënies midis prindit dhe fëmijës. Kjo lloj marrëdhënie në ambientin e fëmijërisë së hershme përfshin shumë komunikim me fëmijën, lojë me të, mirëkuptim dhe të prekur. **Këto eksperiencia të fëmijërisë së hershme përkthehen në: shtim të fjalorit të fëmijës, përdorim të efektshëm të tij, dhe teste inteligjence me rezultat të mirë. Të gjitha këto shërbejnë si parashikues të suksesit në shkollë.**

3. Elementi i tretë është **sfida**. Prindërit nxitin zhvillimin e fëmijës kur ata krijojnë eksperiencia të mësuarit të cilat e sfidojnë fëmijën. Ka një metodë që çon drejt kësaj sfide, e ajo është të ndërtojmë mbi shprehitë që kemi në dispozicion e më pas ta zhvillojmë aftësinë e fëmijës.

4. Duke kaluar në moshën parashkollore, sfida dhe zgjerimi i interesave të fëmijës dhe i stileve të të mësuarit bëhet edhe më i rëndësishëm për shkak të dy aftësive që zhvillojnë fëmijët gjatë viteve parashkollore, vëmendja dhe vetëkontrolli, që u përmendën pak më lart.”

Menaxhimi i stresit dhe emocioneve

Fëmijët e moshës parashkollore duhet të mësojnë të menaxhojnë stresin dhe emocionet për dy arsye:

- 1. Emocionaliteti i pakontrolluar i pengon aftësinë e fëmijëve për të mësuar dhe i bën ata që të kenë një inteligjencë më të ulët dhe më pak arritje.**
- 2. Mënyra e dytë më anë të së cilës emocionaliteti ndikon fëmijët është nëpërmjet stresit.**

Meqenëse ka një lidhje të fortë midis emocionalitetit dhe stresit, dhe të dy ndikojnë aftësinë e fëmijëve për të mësuar dhe për sukses.

KËNDVËSHTRIMI ISLAM MBI INSTITUCIONET PARASHKOLLORE

Ne jemi brezi i parë i të rinjve muslimanë në Shqipëri pas rënies së komunizmit. Si të tillë, ne mbartim traditat dhe zakonet e shoqërisë ku u rritëm, me të mirat dhe të këqijat e saj. Në aspektin e edukimit të fëmijëve, kjo na sjell në pikën e përplasjes së realitetit që kemi lënë pas, me detyrat që na ngarkon mbi shpatulla kjo fe e nderuar, me të cilën na ka bekuar Allahu. Si brez i parë i të rejave dhe të rinjve, përgjegjësia jonë përpara Allahut është më e madhe se e atyre që do të vijnë pas nesh. Tani është momenti kur duhet të vemë përballë dy tradita, traditën Islame dhe atë komuniste. Tash duhet të vendosim një lente kritike në sy për të parë më mirë procesin e edukimit të fëmijëve në Shqipëri. Është momenti më kyç për studim dhe reflektim. Ne kemi nevojë të shkëputemi nga ca zakone që nuk na ndahen dhe janë ngulitur thellë në gjithë ata vjet që kalam në ateizëm. Le të parafytyrojë secili se sa pasardhës do të vijnë pas tij deri në Ditën e Kijametit. Imagjinoni se ju jeni rrënja. Sa degë do të mbushin pemën tuaj? Për të gjithë ata, ne do të jemi përgjegjës. E si do të dalim ne përpara Allahut në Ditën e Përgjegjësisë? Ku i lamë muslimanët e së ardhmes në vitet e para, kujt ia lamë në dorë ta mbillte atë fidan të dobët që quhet personalitet?

Edukimi fetar

Çerdhet apo kopshtet nuk i mundësojnë fëmijës krijimin e një identiteti të pavarur fetar. Kjo për shkak se në

vendin tonë, siç dihet, arsimi është i ndarë plotësisht nga besimi fetar. Fjala Zot nuk përmendet kurrë, ndërkohë që, për zhvillimin e besimit Islam tek fëmija është e domosdoshme që ai të rrethohet nga një ambient ku nuk ka kontradikta midis familjes dhe ambientit rrethues. Për të pasur muslimanë të devotshëm të së ardhmes puna më e rëndësishme që mund të bëjnë nënat është mbjellja e imanit në zemrat e fëmijëve pikërisht në moshën parashkollore. Emri i Allahut duhet ta shoqërojë fëmijën vazhdimisht dhe hadithet e Muhamedit (s.a.v.s) duhet të përmenden në çdo situatë në mënyrë që t'i mësojnë atij mënyrën e sjelljes. Në këtë moshë është shumë e rëndësishme që fëmijës t'i mësohen historinë e jetës së Profetit a.s. si dhe të profetëve të tjerë.

Dikush mund të thotë se kjo mund të realizohet fare mirë edhe në kopshtet e ngritur nga muslimanët. Vërtet atje fëmijët mund të mësojnë disa sure të shkurtra nga Kurani apo hadithe për mënyrën e sjelljes, por nuk mësojnë një gjë shumë të rëndësishme për moshën e tyre: dashurinë e nënës. Është pikërisht kjo dashuri ajo që ua mëson fëmijëve dashurinë për Allahun Fuqiplotë.

“Nga Dashuria te Virtyti” - Necla Koytak, psikologe turke

“-Kam frikë se shejtani do të ketë pjesë tek fëmijët e Ummetit tim.

- Si mund ta shmangim këtë rrezik, o i Dërguari i Allahut?

- Mësojuni atyre Dashurinë dhe Virtytet.”

Muhamedi (s.a.v.s.)

Rezultatet e kërkimeve shkencore tregojnë se, për mirëqenien psikike dhe rritjen psiko-sociale të fëmijës, është një fakt i padiskutueshëm obligimi i nënës për t'i futur ushqim emocional që buron nga Dashuria, së bashku me ushqimin biologjik, veçanërisht gjatë periudhës 0-6 vjeç.

Ky fakt është domethënës sepse, nga njëra anë, ai pasqyron varësinë absolute të realizmit të potencialit të rritjes shumëdimensionale të njeriut drejt elementëve metafizikë, çka do të thotë se, vlerat njerëzore si: Dashuria, durimi, vetësakrifica, altruizmi, etj, jepen vetëm nga nëna. **Ky fakt tregon qartë natyrën personale dhe të patjetërsueshme (të patransferueshme) të rolit të mëmësisë.**

Sistemi i egos që është zhvilluar tek një fëmijë të cilit nuk i është dhënë afeksion dhe dashuri e mjaftueshme gjatë viteve të para të jetës, do të formohet pashmangshmërisht nën ndikimin e fortë të egoizmit, e gjeneruar kjo nga “ndjenja e thellë e ankthit për të qenë i aftë të mbijetojë” dhe “me rritjen e tensionit të shkaktuar nga të qenit në një pozicion midis dëshirave të tij instiktive, për të jetuar një jetë në siguri dhe fuqi, dhe situatës së tij të pashpresë në jetën e vërtetë. Duke brendësuar të tjerët nëpërmjet Dashurisë, fëmija arrin një dimension të brendshëm mbikqyrje (të vetvetes) dhe drejt një baze të shëndoshë të karakterit, të cilës mund t'i verë fre kundër sulmeve të “egos”. **Ky dimension që u ngrit drejt një pozicioni të brendshëm aktiv në një nivel me “veten”, ose “egon”, me fjalë të tjera, me “të huajin brenda nesh”, do të shërbejë si bazë për ngritjen e strukturës morale, e cila do të bëjë që ne lehtësisht dhe natyrshëm “të vendosim veten në vendin e të tjerëve.”** Nëse fëmijës, gjatë viteve të para të

jetës, nuk i jepet mundësia për të kaluar nëpër këtë proces në një mënyrë të shëndetshme, do të përballemi me një nivel të tillë të socializimit që e bën qenien njerëzore të huaj për vetveten dhe për ambientin e tij si pasojë e pashmangshme e natyrës së egër të egoizmit, i cili s'mund të qetësohet me diçka tjetër, veçse me Dashuri.

NËNA, që është personi i parë i pajisur në nivelin më të lartë me cilësi të lindura, për të plotësuar në mënyrën më të përshtatshme të mundshme nevojën që ka rritja e fëmijës gjatë 6-7 viteve të para të jetës, duhet të jetë e varur në një marrëdhënie ndërvarësie të vazhdueshme, intensive dhe fytyrë më fytyrë. Fakti që “personi i parë në shoqëri që shërben si urë lidhëse midis fëmijës dhe shoqërisë është nëna”, vë në dukje funksionin e rëndësishëm të grave në fushën e etikës sociale dhe personale. **Për fëmijën, nëna duhet të jetë personi i parë dhe burimi më i pasur i Dashurisë, e cila shfaq Dashuri dhe afeksion të pakush-tëzuar ndaj fëmijës dhe i mëson atij si t'i dojë të tjerët.** Ky fakt, për fëmijën, tregon rëndësinë e një socializimi të ushqyer krejtësisht nga Dashuria, që nga ditët e para të ardhjes së tij në jetë.

Marëdhënia nënë-fëmijë, gjatë viteve të parë të fëmijërisë, ka avantazhe të jashtëzakonshme, të cilat lehtësojnë mbjelljen e hershme të vlerave njerëzore thelbësore dhe virtyteve, e shfaqur kjo në një spektër të gjerë në sjelljen e nënës mbi strukturën etike të fëmijës. Është krejtësisht e qartë se, nënat duhet ta shfrytëzojnë si duhet pozicionin e tyre strategjik të shkallës tepër të lartë, siç u përmend më lart, në themelimin e strukturës etike të shoqërisë dhe brezave të rinj me ndërgjegjjen e plotë të detyrës. Ajo duhet të forcohet me çfarëdo lloj mbështetje të mundshme, për ta

ndihmuar atë t'i afrohet fëmijës me qëndrime, sjellje, dhe masa edukative që i përshtaten fëmijës, duke vazhduar të shfaqë pa ndërprerje ndjenjat e saj ndërtuese si Dashuria, durimi, etj.

Kjo mbështetje që duhet t'i jepet me synimin për ta ndihmuar nënën të ndihet mirë, dhe të sillet në një mënyrë të dashur, të përzemërt dhe fisnike, larg nga tensionet, duke e liruar atë nga çdo lloj shqetësimi, duke nisur që nga ato ekonomike, e deri tek ato që lidhen me atmosferën familjare. Kjo mbështetje duhet të përfshijë “mbështetjen morale të babait”, ndihmë ekonomike, për të siguruar qetësinë shpirtërore të nevojshme dhe veçanërisht mbështetje edukative që do t'i jepet nënës në rrugë të ndryshme.

Duke patur parasysh se dy të tretat e zhvillimit intelektual të fëmijës zhvillohen gjatë 6 viteve të para të jetës, atëherë, nëna duhet të marrë ndihmë edukative. Ajo është faktori më i rëndësishëm në shtrimin e themelit të të menduarit të lirë, produktiv dhe krijues, në vend të imitimit. Gjithashtu, nëna duhet të marrë ndihmë edukative në forcimin e kapacitetit të fëmijës për të analizuar, sintetizuar dhe izoluar në zhvillimin e tij gjuhësor dhe në mbështetjen e mekanizmit të tij intelektual që do të mbështetet mbi arësyetim, të kuptuar dhe përvehtësim, në vend të memorizimit të thjeshtë.

Qëllimi i kërkimit shkencor të quajtur **“Projekti i Zhvillimit të Hershëm tek Fëmija dhe Edukimi i Nënës”**, i cili u nis në vitin 1982 në Universitetin e Bogaziçi, nën drejtimin e Prof. Ç. Kagitçibasi, (rezultatet e të cilit u shpallën më 1991), ishte të ndihmonte nënat të mbështesnin zhvillimin e fëmijëve të tyre, duke u bërë më të ndjeshme

dhe duke i kushtuar më tepër vëmendje nevojave të tyre fizike, emocionale, intelektuale dhe sociale. **Rezultatet e përfituara tregojnë faktin se: Për vlefshmërinë dhe suksesin e edukimit parashkollor, që kontribuon gjerësisht në zhvillimin shumëdimensional të fëmijës, ai duhet të edukohet nga një nënë e shkolluar, në ambientin e tij, pa u veçuar (larguar) nga familja.**

Roli i gruas në familje, në shoqëri dhe punësimi i saj sipas fesë Islame

Kur flasim për këtë temë kaq delikate nuk mund të lëmë pa përmendur shkurtimisht se cili është roli i gruas muslimane në familje dhe në shoqëri, dhe cila është pikëpamja islame mbi punësimin e gruas si nënë. **Jusuf Kardaui** në librin e tij **“Fetva bashkëkohore”** thotë: “Nëse e lejojmë punën e gruas, atëherë duhet të plotësohen disa kushte:

1. Puna duhet të jetë e ligjshme, nuk duhet të çojë në haram, etj.
2. Ajo duhet t’u përmbahet rregullave islame kur del prej shtëpisë dhe
3. Mos të jetë puna e saj në llogari të detyrimeve të tjera, të cilat nuk guxon t’i neglizhojë, siç janë detyrimet ndaj burrit dhe fëmijëve, të cilat janë në fakt obligimi i saj i parë dhe puna kryesore.”

Amër Halid në librin **“Rëndësia e familjes në Islam”** shprehet:

“Gruaja është krijuar për t’i falur njerëzimit dhembshurinë, dashurinë dhe prehjen që i mungon. Ky është roli kryesor dhe primar i gruas. Roli dhe misioni i dytë është se ajo rrit dhe edukon brezat e ardhshëm dhe i treti është të arsimohet dhe të punojë. Madhështia dhe vlerat e tua si grua qëndrojnë në ekuilibrin midis këtyre tre obligimeve dhe misionëve, mes dashurisë, edukimit të fëmijëve dhe kontributit në shoqëri. Nëse suksesi yt në shoqëri çon në dështimin tënd si bashkëshorte dhe nënë, do të ishte i mangët dhe i padobishëm. Ndërsa në librin **“Nënat e besimtarëve,”** ai shprehet: “Shpresa për të rregulluar shoqërinë ndodhet tek gratë. Nëse ka shpresë për triumfin e muslimanëve, ai lidhet drejtpërdrejt me kontributin e grave.

Mjaft nëna muslimane zgjedhin të punojnë qoftë për arsye ekonomike, ose për të realizuar dëshirat e tyre, gjatë viteve të para të jetës së fëmijëve, duke ia lënë detyrën e tyre të rëndësishme çerdheve, kopshteve apo gjyshërve. Psikologet muslimane, **Dr. Aisha Hamdan dhe Wahida Valiante,** shprehen se të dyja zgjidhjet nuk janë të përshatshme dhe të mjaftueshme për fëmijën, sepse kopshtit, në vetë natyrën e tij, i mungon kujdesi i individualizuar emocional, shpirtëror dhe intelektual për të cilin ka nevojë fëmija. Gjithashtu, ambienti social i tij është i predispozuar për uniformitet në procesin e socializimit dhe nuk le vend për të zhvilluar një identitet të pavarur fetar, apo social. Ne nuk mund të heqim dorë nga përgjegjësia jonë e rritjes dhe edukimit të fëmijëve duke ia lënë në dorë cil-itdo profesionisti apo edukatori të mbjellë vlerat etike dhe morale tek fëmijët tanë duke e pasur modelin e gatshëm në shtëpi.

Profeti (s.a.v.s) thotë: **Nëse një musliman ka tre fëmijë dhe ata vdesin para moshës së pubertetit, Allahu do ta futë atë në Xhennet për shkak të mëshirës së tij ndaj tyre.** (Transmetuar nga Enes bin Malik). Ku është mëshira jonë kur foshnjën, apo fëmijën 3-6 vjeç, e marrim dhe e lemë si plaçkë pa ndjenja dhe nevoja të vetat, për disa orë rresht nën kujdesin e njerëzve të panjohur, e aq më keq akoma, jomuslimanë? **Si ka mundësi që të na jenë mbyllur sytë kaq sa të mos shohim se ku po i lemë muslimanët e së ardhmes, në dorën e kujt?** Përse Profeti (s.s.v.s) e përmend mëshirën në këtë moshë? Pikërisht për faktin se nevoja e fëmijës për të, në këtë moshë, është më e madhe sepse ai në këtë moshë formohet si individ më vete.

Xhenneti ndodhet nën këmbët e nënës. Kur ndodhemi përballë këtij hadithi është njëlloj si të ndodhemi përballë një monamenti. Vallë a do të ndodhet Xhenneti nën këmbët tona kur ne po çalojmë me një këmbë drejt feminizmit dhe tjetrën drejt kapitalizmit? Le t'i kthehemi praktikës islame, rrugës së mesme, ta vlerësojmë lart detyrën që na ka ngarkuar Allahu xh.sh. dhe t'i japim vetes vlerën që meriton.

Ndërsa një hadith tjetër u drejtohet grave duke u thënë: **“Kujdesuni për shtëpinë. Ky është xhihadi juaj.”** (Musnedi i Ahmedit) A ka gjë më të lartë që mund të kryejnë gratë, se sa përpjekja në rrugë të Allahut? A nuk është xhihad edukimi i një fëmije? Kush udhëzon një njeri është si t'i kishte udhëzuar të gjithë njerëzit.

Shprehja në vijim, thënë nga goja e Profetit tonë Muhammed, (s.a.v.s.) përbën një paralajmërim serioz për burrat, ku iu kërkohet atyre t'i mbështesin gratë: **“Fjala**

“rahm” (mitra e nënës) vjen nga e njëjta rrënjë me fjalën “rahijm” që do të thotë Mëshiruesi, Mëshirëbërësi, të cilët janë attribute të Allahut. Kush e mbështet dhe e forcon atë, (gruan) do të mbështet dhe forcohet nga Allahu; kush e lëndon atë, do të lëndohet nga Allahu”.

Familja shqiptare

Familja shqiptare tradicionalisht ka vuajtur dhe vuan nga shumë plagë. Disa nga ato janë: dhuna, e çfarëdo lloj forme qoftë ajo, padituria në fushën e edukimit të fëmijëve, lënia pas dore, etj, etj. Si një shoqëri në zhvillim na duhet shumë punë për të mbushur vakumin që na mbetur nga nënat tona. “Pse nuk më mësoi nëna ime më parë?” është një pyetje që mbetet si të thuash pa përgjigje. Edukimi i fëmijëve në Shqipëri i lihet rastësisë. Mendimi i përgjithshëm i njerëzve është: “Fëmijët do të rriten”, aq sa i kemi dëgjuar gjyshërit tanë të thonë: “Ja, të shohim ç’rrugë do të marrin”. Por, ne të rrinjtë muslimanë nuk mund të rrimë spektatorë, të presim që fëmija ta gjejë vetë rrugën e tij të mbarë. Fëmijët këtu dhunohen, gënjehen, mashtrohen, manipulohen si qenie pa të ardhme shpirtërore, por vetëm ekonomike. Ndaj duhet të jemi shumë të mprehtë për të dalluar se çfarë është e mirë dhe e drejtë e trashëguar nga tradita jonë e lashtë shqiptare dhe çfarë bie ndesh me sunnetin e Profetit (s.a.v.s.) përta përket projektimit të së ardhmes tonë tek fëmijët tanë të shtrenjtë.

Islami e ka bërë nënën përkujdesësen dhe mësuesen e parë të njeriut në vitet e parë të jetës. Hadithi i Profetit (s.a.v.s) **“Të gjithë ju jeni barinj dhe jeni përgjegjës për**

tufën tuaj, gruaja është përgjegjëse për shtëpinë dhe fëmijët,” tregon natyrën e patransferueshme të kësaj përgjegjësie. Ky hadith është shumë i njohur për ne, por puna është se, nuk po e zbatojmë si duhet atë. Duke mos ditur, dhe duke mos njohur mirë rëndësinë që kanë vitet e para të jetës në zhvillimin e fëmijës, kemi zgjedhur që këtë përgjegjësi ta ndajmë me dikë tjetër, në këtë rast, me njerëz shumicën e rasteve të huaj, pa asnjë lidhje farefisnie, aq më keq akoma, me njerëz pabesimtarë, me sjellje dhe karakter të dyshimtë. Praktika e braktisjes së fëmijëve të vegjël nëpër institucione u përhap në Amerikë në shekullin e kaluar pas lindjes së lëvizjes feministe. Lind pyetja: Çfarë të përbashkët ka Islami me feminizmin? Në Shqipëri ky fenomen u krijua nga komunizmi. Çfarë të përbashkët ka Islami me komunizmin? Dje nisi krijimi i personaliteteve socialiste dhe qëllimi i masave që u morrën në Shqipëri ishte krijimi i “personalitetit socialist”, që duhej të fillonte që në moshë të hershme. Po ne, çfarë personaliteti duam të ndërtojmë tek fëmijët tanë, apo atë të ekonomisë së tregut e cila “militon drejt barazisë dhe humbjes së identitetit personal?” Fëmijët janë amanet i shenjtë nga Allahu, për të cilët do të pyetemi se si e kemi realizuar detyrën e ngarkuar.

Nëse duam që fëmijët tanë të bëhen besimtarë të devotshëm dhe njerëz që do të përhapin fenë Islame në Shqipëri, duhet ta nisim punën qysh herët. Nëse duam që ata të bëhen muslimanë me karakter të fortë, të palëkundur përballë shoqërisë jobesimtare, puna fillon pikërisht në këta vitet e parë, kur ata formohen si individë të pavarur. Sa i pavarur mund të bëhet ky musliman kur në edukimin e tij ushtrohet çdo ditë dhunë. Ai është çdo ditë i detyruar të qëndrojë me orë të tëra në karigen e vogël dhe nuk është

i lirë të jetë pranë mamit dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes së tij dhe nuk është i lirë të bëjë atë që dëshiron ai.

Le ta pyesim veten: Nëse Profeti Muhamed (a.s.) do të ishte midis nesh, a do të dëshironte që Ummeti i tij të rritej nëpër institucione? Po nëna muslimane ku është? Ku humbi sakrifica e saj?

Ajo që na mbetet për të bërë është studim dhe vetëm studim, qoftë shkencor, qoftë fetar i eksperimentimit me fëmijët dhe të mos mbetemi viktimë të shpëlarjes së trurit nga ambienti që na rrethon.

Nëse do të duhej të përgatitej për diçka femra muslimane sot, ajo është të qënit nënë, profesioni me të cilin e ka Allahu i Madhëruar e ka nderuar, e ka bërë udhërrëfyese dhe të parën mësuese për brezat. Nëse do të duhej të studionte diçka nëna muslimane sot, ajo është dituria mbi fazat e zhvillimit të fëmijëve, zhvillimin e trurit, formimin e karakterit dhe të personalitetit. Kështu ajo do të zbulojë se Allahu i Madhëruar i ka dhënë forcë për të ndryshuar vetveten dhe fuqi shpirtërore për të ndikuar familjen dhe shoqërinë e saj.

Disa nga Shenjat e Kijametit në lidhje me prindërit dhe fëmijët

Atë ditë secila gjdhënëse e flak atë që ka për gjiri dhe secila shtatzënë e hedh para kohe barrën e saj. Njerëzit duken të dehur. Ata nuk janë të dehur por, dënimi i Allahut është i ashpër. (Sure Haxh: 2)

Ky ajet është paralajmërim se çdo të ndodhë në kohët e fundit me njerëzit në mënyrë masive: ndarja e nënës nga fëmija dhe abortet e shumta.

Humbja e amanetit

Profeti (s.a.v.s.) ka thënë: **Kur të humbë amaneti atëherë prite Kijametin**

A nuk janë fëmijët tanë amanet prej Allahut?

Kur të lindë robëresha zotërinë e saj, atëherë prite Kijametin.

Me largimin masiv të përgjegjësisë për fëmijët, vjen edhe dënimi tjetër: Prindërit bëhen të paafte të edukojnë fëmijët e tyre. Me politikat sociale që krijojnë shtetet ateiste bëhet thuajse e pamundur për gruan qëndrimi në shtëpi në vitet kur fëmijët kanë më shumë nevojë për të. Me lejen e lindjes vetëm 1 vit nënave u duhet të mendohen mirë para se ta hedhin hapin për të dalë me kohë të plotë në punë.

Feminizmi

Ende në botë vërtitet si re e errët feminizmi, pjellë e teorisë së evolucionit, e cila është provuar të jetë lëvizja më shkatërruese për njerëzimin në kohët e fundit që po përjetojmë. Ai arriti që ta shkatërrojë rolin e nënës duke shkatërruar kështu edhe familjen në përgjithësi. Lidhjet familjare i zëvendësoi me besnikërinë ndaj vendit të punës dhe fëmijët ia besoi shtetit. Simone de Beauvoir, një nga intelektualet e feminizmit modern është shprehur se: “Grave nuk duhet t’ua lejojmë zgjedhjen e të qëndruarit në shtëpi, sepse nëse do të ekzistonte një zgjedhje e tillë shumë prej tyre do ta bënë atë.”

Tashmë shumë psikologë e studiues në Amerikë, Kanada, Angli, si dhe nëpër vende të tjera të botës, janë përfshirë në një betejë ideologjike e studimore në lidhje zhvillimin e fëmijës, me përkujdesjen ndaj tyre si dhe në lidhje me rolin e pazëvendësueshëm të nënës. Allahu i Madhëruar ua ka bërë të mundur që t’i vërtetojnë shkencërisht argumentet e Tij dhe të kuptojnë se çfarë kanë punuar me duart e tyre.

Një faqe interneti që po e realizon këtë është: www.daycaresdontcare.org e cila përmban mjaft artikuj që nxjerrin në pah natyrën e vërtetë të edukimit parashkollor dhe mjaft libra të shkruar nga psikologë që e kanë studiuar këtë çështje. I ftoj të gjitha motrat muslimane të mendojnë pak më thellë: KOPSHTË, ÇERDHE – ZGJIDHJE, APO ZGJEDHJE?

Falënderimet janë për Krijuesin e Madhërishëm që ma bëri të mundur hartimin e këtij studimi, dhe paqja dhe mëshira qofshin mbi Profetin Muhamed, familjen e tij, shokët e tij dhe gjithë besimtarët deri në ditën e gjykimit!

Literatura e shfrytëzuar

1. **Rëndësia e zhvillimit të hershëm të fëmijës**, www.youtube.com
2. **7 nevojat psikologjike të fëmijëve**, www.allabout-livingwithlife.com
3. www.daycaresdontcare.org
4. **Realiteti i Kujdesit Ditor**, Gwen J. Broude, Vassar College (1996)
5. **Kujdesi Ditor lidhet me Sjellje Agresive, Kokëfortësi dhe Kundërshtim**, Shumica dërmuese e fëmijëve brenda rangut normal, Korrik 2003 Instituti Kombëtar i Shëndetit dhe Zhvillimit të Fëmijës www.nichd.nih.gov
6. **Ndikimi i kujdesit ditor të hershëm mbi atashimin me nënën** - Jay Belsky
7. **Inkubatori i Shoqërisë**, Necla Koytak, Botim i shoqatës kulturore “Gruaja” Tiranë 2007
8. **Bebet në Kujdes Ditor**, Ellen Ruppert Shell, Gusht 1988
9. **Bota e Psikikës Fëmijërore**, Stanisha Nikoliq, Furkan ISM Shkup, 2005
10. **Atashimi fillon me lindjen**, Dr. Aisha Hamdan
11. **Të jesh Nënë, Eksperienca Emocionale e Mëmësisë pas Frojdit dhe Feminizmit**, Elaine Heffner, Nju Jork, 1978

12. **Formimi i karakterit të shkëlqyer tek fëmijët**, Prof. Dr. Muhamed El-Mehdi Furkan Ism, Shkup, 2010

13. **Formimi i personalitetit tek fëmijët**, Prof. Dr. Muhamed El-Mehdi, www.islamic-world.net

14. **Day Care Deception - Mashtrimi i kopshte-çerdheve**, Brian C. Robertson 2003

15. **Si mësojnë fëmijët**, Dr. Caron Goode - Kevin Heath 2010

16. **Tre konceptet bazë mbi zhvillimin e fëmijës**, nga Këshilli kombëtar shkencor mbi zhvillimin e fëmijës, Universiteti i Harvardit, www.youtube.com

17. **Allan Schore**, Neurobiogjia e atashimit të sigurt www.youtube.com

18. **Allan Schore**, Atashimi dhe hemisfera e djathtë e trurit, www.youtube.com

19. **Allan Schore**, Atashimi, www.youtube.com

20. **Eksperienca ndërton arkitekturën e trurit të fëmijës**, nga developingchild.harvard.edu

21. **Sinkronizimi fytyrë më fytyrë**, David Arredondo, www.youtube.com

